

1 E hënë, 28 mars 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Sekretar, ju lutem paraqitni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar

8 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i

9 Specializuar kundër Salih Mustafës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Të shohim atëherë. Të paraqiten të pranishmit.

13 Z. Prokuror, kush është i pranishëm për ZPS-në?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

15 Mirëdita të gjithëve. Ekipi i Prokurorisë përfaqësohet sot nga

16 Silvia D'Ascoli, Ndhmësprokurore; Julie Mann, Menaxhere e

17 Lëndës për sot; kemi një stazhiere dhe unë jam Cezary

18 Michalczuk, Prokuror.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Znj. Mbrojtëse e Viktimave.

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

23 Mirëdita të gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse përfaqësohen sot

24 nga Brechtje Vossenberq si Bashkëmbrojtës dhe unë Anni Pues,

25 si Mbrojtëse. Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse.

5 Mbrojtja përfaqësohet sot nga z. Betim Shala, Bashkëmbrojtës;

6 z. Fatmir Pelaj, hetues dhe përkthyes; unë Julius von Bone.

7 Dhe në sallë sot është i pranishëm dhe z. Mustafa.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit

11 Gjykues Nr. 1.

12 Sot do dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes numër

13 300, z. Ahmet Ademi.

14 Por përpara dua që të trajtoj dy gjëra dhe do të dëshiroj

15 që të lëshoj një urdhër gojarisht.

16 E para, Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka nxjerrë të

17 enjten, më datë 24 mars, materialin që synon të përdorë gjatë

18 kundërpjetjeve që do t'ia bëjë Dëshmitarit 300. Kemi vënë re

19 gjithashtu se Mbrojtja ka dorëzuar në *Legal Workflow*

20 dokumentet që synon të përdorë në pyetjet që do t'ua bëjë

21 Dëshmitarëve 300, 400 dhe 500. Dhe këtë e ka bërë të mërkurën,

22 më datë 23 mars, në pajtim me paragrafin 34 të Vendimit për

23 Zhvillimin e Procesit. Trupi Gjykues e vlerëson marrjen e

24 këtyre dokumenteve paraprakisht dhe ju nxit që të vazhdoni të

25 veproni kështu dhe në të ardhmen.

1 Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja gjithashtu ka
2 dërguar një email dje, 27 mars, në orën 11.40, ku ka bërë të
3 ditur se cilat materiale synon t'i përdorë gjatë këtyre
4 dëshmimeve. Trupi Gjykues e kujton Avokatin e Mbrojtjes se afati
5 për dërgimin e këtyre dokumenteve përmes postës elektronike
6 vazhdon të jetë pesë ditë përpara fillimit të dëshmisë së
7 dëshmitarit në përputhje me paragrafin 34 të Vendimit për
8 Zhvillimin e Procesit.

9 Tjetra që dua të trajtoj është një urdhër gojarisht
10 lidhur me materialin e nxjerrë nga ZPS-ja. Trupi Gjykues vëren
11 se ZPS-ja i ka kërkuar leje Trupit Gjykues të përdorë material
12 nga burim i hapur të nxjerrë rishtazi dhe këtë ta bëjë me
13 Dëshmitarin 300 në kundërpjetjet. Këtë kërkesë e ka bërë në
14 datë 24 mars, të enjten me e-mail, të dërguar në 16.50.

15 Trupi Gjykues mendon se ZPS-ja ka kërkuar lejen e Trupit
16 Gjykues në pajtim me paragrafin 31 të Vendimit për Zhvillimin
17 e Procesit dhe ka bërë të ditur pse ky material nuk është
18 nxjerrë përpara.

19 Trupi Gjykues konstaton se ZPS-ja ka treguar arsye të
20 vlefshme për mosnxjerrjen më përpara të këtij materiali dhe
21 merr parasysh që ky është material nga burim i hapur.

22 Trupi Gjykues, rrjedhimisht e lejon ZPS-në ta përdorë
23 këtë material gjatë kundërpjetjeve që do t'ia bëjë Dëshmitarit
24 të Mbrojtjes me numër 300.

25 E treta ka të bëjë me diçka tjetër.

1 Trupi Gjykses vëren urdhrin, më falni, Trupi Gjykses
2 vëren rendin e dëshmime që do të japin dëshmitarët për muajt
3 mars dhe prill, siç është vendosur në dispozicion nga avokati
4 i Mbrojtjes, në parashtrimet e protokolluara me numër 361, ku
5 ka bërë të ditur se këtë javë do të jetë Dëshmitari 300 më 28
6 mars; Dëshmitari 400 më 29 mars; dhe Dëshmitari 500 më datë 30
7 mars.

8 Trupi Gjykses nuk parashikon që të vijojë kështu. Trupi
9 Gjykses ka vendosur me urdhrin të lëshuar gojarisht më 9 mars
10 dhe kjo është në rreshtat 5 deri në 7 të faqes 2525 të
11 transkriptit të datës 9 mars, që këtë javë, nëse është e
12 mundshme të dëgjohen tre dëshmitarë, që është synimi i Trupit
13 Gjykses që ta përdorë të gjithë ditën. Kjo do të thotë që nëse
14 dëshmia e dëshmitarit të parë do të përfundojë sot më përpara
15 se ora 4.00, do të thirret dhe dëshmitari i dytë të japë
16 dëshminë e tij apo një pjesë të dëshmisë nëse është e mundshme
17 dhe nëse është e arsyeshme.

18 Arsyeja për këtë është që të mos mbetemi pa kohë të
19 mjaftueshme në fund të kësaj jave.

20 Në rregull atëherë. Shoh që z. Prokuror është ngritur në
21 këmbë.

22 Z. Prokuror, keni fjalën.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, një
24 çështje përpara se të filloj me dëshmitarin.

25 Deri në fund të secilit muaj me vendim të Trupit Gjykses,

1 palët duhet që të dorëzojnë kërkesën për paraqitjen e
2 dokumenteve që do të përdorin me dëshmitarët. Siç e filluam
3 këtë muaj vonë me dëshmitarin e parë javën që shkoi do të
4 vazhdojmë me tre dëshmitarë këtë javë. Ne duhet të dëshirojmë
5 të bëjmë një kërkesë bashkërisht me Mbrojtjen se kemi rënë
6 dakord me të. A mund t'i kërkojmë leje Trupit Gjykues që këtë
7 parashtrim ta dorëzojë deri në fund të javës së ardhshme - më
8 falni, jo të javës së ardhshme - deri më datë 8 mars nëse
9 është e mundshme - ah ju kërkoj ndjesë - prill atëherë. I
10 ngatërruakam datat sot.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka
12 problem.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Javën e ardhshme, 8 mars - jo,
14 8 prill. 8 prill.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
16 mendojmë shumë shkurt. Kërkesa parimisht duket në rregull por
17 do ta mendojmë sesi do ta organizojmë dhe pastaj do t'ju japim
18 përgjigje.

19 Keni diçka tjetër z. Avokat i Mbrojtjes?

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, e nderuara Gjykatëse.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 rregull. Faleminderit, z. Avokat.

23 Mund të vazhdojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit me numër
24 300.

25 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroni dëshmitarin

1 të hyjë në sallë.

2 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Mirëmëngjes, z.
4 Ademi.

5 DËSHMITARI: Mirëmëngjes juve, ju përshëndes, punë të
6 mbarë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 se keni ardhur në Dhomat e Specializuara. Më dëgjoni në
9 rregull?

10 DËSHMITARI: Po. Mirë se ju gjej. Po dëgjoj mirë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Ademi, ju lutem që të flisni me zë pak më të lartë dhe me afër
13 mikrofonit, në mënyrë që t'ju dëgjojnë sa më mirë përkthyesit.

14 DËSHMITARI: Mirë, falemnders.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
16 jeni?

17 DËSHMITARI: Mirë, faleminderit, mirë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
19 mirë.

20 Z. Ademi, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Ju kanë
21 thirrur të dëshmoni në çështjen gjyqësore Prokurori i
22 Specializuar kundër Salih Mustafës, për ta ndihmuar Trupin
23 Gjygues që të marrë një vendim.

24 Pasi të keni bërë betimin solemn për të thënë të vërtetën
25 do t'ju bëjë pyetje në fillim avokati i Mbrojtjes së z.

1 Mustafa, i cili është ulur në të djathtën tuaj. Pastaj
2 avokatja që përfaqëson viktimat që marrin pjesë në proces, që
3 është e ulur në të majtën tuaj më afër, përfaqësuesit e
4 Prokurorisë, të cilët janë ulur pranë Mbrojtëses së Viktimave,
5 shikoni pakëz më larg nga ju, majtas jush.

6 DËSHMITARI: I përshëndes.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
8 në fund mbase mund t'ju bëjnë pyetje edhe Gjykatësit që janë
9 anëtarë të këtij Trupi Gjygues. I kuptuat të gjitha këto?

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Dëshiroj t'ju jap tani disa udhëzime se si t'u përgjigjeni
13 pyetjeve që do t'jua bëjmë.

14 Z. Ademi, ju lutem dëgjojeni me kujdes secilën pyetje.
15 Nëse nuk e kuptoni, lirisht mund të kërkoni që pyetja t'ju
16 përsëritet. Duam që të na thoni të vërtetën. Të na tregoni se
17 çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar,
18 çfarë keni ndier ju vetë. Nëse nuk e keni parë, dëgjuar,
19 përjetuar apo ndier vetë, na e thoni dhe na shpjegoni se si
20 keni -- dijeni për atë gjë.

21 Mund të mos ju kujtohet gjithçka, të gjitha hollësitë e
22 ngjarjeve - kjo nuk ka problem. Na tregoni vetëm aq sa mbani
23 mend. Nuk ka asnjë problem nëse thoni, "nuk e di" apo "nuk më
24 kujtohet".

25 Ju rikujtoj se edhe mund të mos pranoni që të jepni

1 dëshmi për gjëra të cilat mund t'ju fajësojnë juve vetë, në
2 përputhje me rregullin 151(1) të Rregullores. Këtë të drejtë e
3 keni.

4 I kuptuat të gjitha këto, z. Ademi?

5 DËSHMITARI: Po. Po, i kuptova.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
7 shumë mirë.

8 Dëshiroj që t'ju jap edhe disa këshilla praktike për
9 dëshminë tuaj. Si fillim çdo gjë që thuhet këtu, përkthehet
10 dhe regjistrohet. Është e rëndësishme pra që siç jua thashë
11 dhe më përpara të flisni afër mikrofonit, të flisni qartë dhe
12 të flisni ngadalë, sepse kështu përkthyesit mund të përkthejnë
13 më mirë. Duhet të filloni të flisni vetëm pasi të ketë mbaruar
14 pyetjen personi që po jua bën pyetjen. Pra edhe pse ju duket
15 sikur e keni gati përgjigjen, prisni të mbarojë njëherë
16 pyetja, pastaj të përgjigjeni. Dhe mbasi të mbarojë pyetja,
17 numëroni me vete deri në pesë. Dhe vetëm pasi të keni numëruar
18 deri në pesë, mund ta jepni përgjigjen sepse kjo pauzë prej
19 pesë sekondash është shumë e rëndësishme për ne, që të
20 dëgjojmë siç duhet atë që thoni ju, të përkthehet, të
21 regjistrohet.

22 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim, mjafton të
23 ngrini dorën dhe unë do t'ju jap fjalën dhe ju mund të thoni
24 se për çfarë keni nevojë.

25 I kuptuat të gjitha këto, z. Ademi?

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, e kuptova.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë. Siç veprojmë me çdo dëshmitar, do t'ju kërkojmë që të
4 lexoni deklaratën solemne, betimin solemn për të thënë të
5 vërtetën. Ju rikujtoj se është vepër penale brenda
6 juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhënia e testimonisë
7 së rreme. E kuptoni këtë?

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
10 që tekstin jua kanë dhënë.

11 Z. Ademi, ju lutem lexoni tekstin që jua kanë vendosur
12 përpara.

13 DËSHMITARI: Në rregull.

14 Betimi solemn:

15 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe
16 përgjegjësisë time ligjore të deklaratës solemne, se do të
17 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
18 nuk do të mbaj të fshehur asgjë për të cilën kam në dijeni.

19 DËSHMITARI: AHMET ADEMI

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, z. Ademi. Tani jeni nën betim për të thënë të
22 vërtetën. Shumë mirë.

23 Mund të fillojmë atëherë, z. Avokat, me dëshminë e z.
24 Ademi. Do të fillojmë me ju z. Avokat. Keni vlerësuar se ju
25 nevojiten dy orë për pyetjet. Si zakonisht ju lutem

1 informoheni Trupin Gjykses për çdo ndryshim që mund të keni
2 për këtë, në mënyrë që të bëjmë planifikimet e nevojshme.

3 Keni fjalën.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
5 Gjykatëse.

6 Pyetje nga z. Von Bone:

7 Py. Z. Dëshmitar, mirëdita.

8 Pë. Mirëdita.

9 Py. Ju lutem të flisni me zë më të lartë dhe më afër
10 mikrofonit sepse mezi dëgjoheni.

11 Pë. Në rregull.

12 Py. Faleminderit shumë. Z. Dëshmitar, dëshiroj që t'i
13 kthehemi, të kthehemi pas në kohë, në periudhën gjatë së cilës
14 ndodhi konflikti në Kosovë, në vitin 1998 dhe 1999. Gjatë
15 periudhës së luftës, ju vetë me se merreshit atëherë?

16 Pë. Po. Gjatë periudhës së luftës unë kam punuar në Kryqin e
17 Kuq të Kosovës, prej moshës 28-vjeçare deri ne vitin 1997 kam
18 punu në Kryqin e Kuq. Në vitin 1997 na kanë larguar prej punës
19 edhe tani kemi vepruar ilegalisht, kemi hapur një zyrë të
20 Kryqit të Kuq të Kosovës për popullatën tonë.

21 Atë e kemi ba se Kryqi i Kuq i Serbisë atëherë ne na
22 dëboi nga puna në 1997-n. Në vitin 1997 me Profesorin Jusuf
23 Dedushaj dhe me anëtarët e tjerë kemi hap një zyrë të Kryqit
24 të Kuq ilegalisht, e cila ka vepruar në Prishtinë edhe në
25 mbarë Kosovën mujt të ketë shkuar.

1 Py. Në Prishtinë, ku ju së bashku me z. Jusuf Dedushaj e
2 ngritët, e vendosët këtë zyrë apo këto mjedise - ku në
3 Prishtinë? Pra ku në Prishtinë ndodheshin?

4 Pë. Ndodheshin në Prishtinë në zyrën mujt ta quash ashtu,
5 private. Kemi qenë në zyrën në drejtim të Gërmisë afër
6 shkollës së mesme, gjimnazit. Aty e kemi pasë, jemi vendosur
7 dhe kemi hapur një zyrë për Kryqin e Kuq të Kosovës në atë
8 kohë. Edhe aty kemi ba punët tona, aktivitetet tona.

9 Py. Kjo shtëpi private në drejtim të Gërmisë ishte shtëpia
10 juaj private?

11 Pë. Jo. Shtëpia jonë nuk ka qenë. Ka qenë me shqiptarët në
12 atë kohë, të cilët na kanë lejuar për të vepruar veprimtarinë
13 tonë si Kryqi i Kuq.

14 Py. Po ju vetë, shtëpinë e kishit në Prishtinë? Dhe nëse po,
15 ku në Prishtinë?

16 Pë. Unë shtëpinë e kom pasë timen, po te vendi ku kemi punuar
17 në Kryqin e Kuq është një kilometër e pak metra q'ashtu. Një
18 kilometër e dyqind-treqind metra prej vendit të punës deri te
19 shtëpia ime.

20 Py. Thatë pastaj që ajo shtëpia private ku e ushtronit atë
21 aktivitet ishte diku në Gërmi. Mund të na thoni se ku ndodhet
22 Gërmia? Unë e kuptoj që është në Prishtinë po është në veri,
23 lindje, jug, perëndim apo është në qendër? Ku është në
24 Prishtinë?

25 Pë. Po është në, qysh me thonë, është në jug. S'po di qysh i

1 bjen. Në jug ndodhet. Apo perëndim. Perëndim si duket.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Një aspekt praktik, e nderuar
3 Gjykatëse. Më duket se e kam të thyer këtë sendin këtu
4 përpara. Do të doja të merrja një tjetër.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Patjetër z. Avokat. Madje kjo do të na ndihmonte të gjithëve
7 sepse mikrofoni juaj bën shumë zhurmë nga lëvizja e asaj.
8 Është më mirë me këtë?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.
10 Py. Shtëpia private, të cilën po e përdornit, ishte një prej
11 zyrave. Keni pasur zyra dhe në vende të tjera? Pra, flas për
12 zyra të Kryqit të Kuq.

13 Pë. Po, kemi pasë edhe një zyrë në Dardani, e cila ka
14 ekzistuar deri në vitin 1998. Aty ka punuar doktori i ndjerë,
15 Shpëtim Rabaj. Kemi punuar edhe ne me të si staf, ndihmës i
16 tijna. Në Dardani, në lagjen Dardani ka qenë një zyrë edhe të
17 rrugës për Gërmi, te shkolla gjimnazit e qujmë ne, afër
18 gjimnazit ka qenë edhe qe ajo zyrë. Domethënë dy zyra kanë
19 qenë në Prishtinë.

20 Py. Kishte ndonjë dallim midis këtyre zyrave? Dallonin nga
21 njëra-tjetra? Pra midis këtyre zyrave që përmendët ju për
22 shembull, në Dardani pranë gjimnazit ku kishte zyra të cilat i
23 kishit vendosur ju, kishin ndonjë strukturë tjetër?

24 Pë. Po, ka pasun dallim se prej zyrës te zyra, prej Dardanisë
25 te rruga për Gërmi që të çon te gjimnazi ka qenë një hapësinë,

1 ka qenë një rrugë e gjatë për neve sidomos se u deshke me punu
2 fshehurazi si Kryqi i Kuq i Kosovës. Edhe prej zyrës në zyrë
3 kemi pasë disa - qysh si ta quaj - disa telashe kështu, se u
4 deshke me u rujt, me u rujt prej...

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Avokat, i është përgjigjur pyetjes dëshmitari?

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo. Do ta bëj prapë pyetjen.
8 Py. Pyetja ime është kjo: Edhe këto zyra ishin edhe këto
9 nëpër shpi private apo ishin në ndërtesa të një lloji tjetër?
10 Folëm për atë zyrën që ishte në Gërmi, që ishte në shtëpi
11 private. Këto zyrat e tjera, ishin dhe këto në shtëpi private?
12 Pë. Po ajo ka qenë në Dardani. Ka qenë Kryqi i Kuq. Ka qenë
13 edhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar edhe Kryqi i Kuq i Kosovës. Disa
14 punëtorë kanë qenë ndërkombëtarë edhe disa punëtorë kanë qenë
15 të komunitetit shqiptar. Ajo ka qenë në Dardani. Ka qenë si ta
16 quaj banesë kështu lokale janë kanun poshtë, banesë, zyrat i
17 ka pasun Kryqi i Kuq.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Avokat, a mund të bëni pyetje se për cilën periudhë kohore po
20 flet dëshmitari sepse është e paqartë he për he periudha
21 kohore?

22 Z. VON BONE:
23 Py. Shtëpia e parë private që ishte në Gërmi, zyra në Gërmi
24 më saktë, ishte e para zyrë që ju e krijuat?

25 Pë. Zyra në Gërmi ka qenë e dyta mbasi që janë vendosur në

1 Dardani mjekët dhe stafi i punës tjetër. Po për hir të
2 hapësirës e kanë çel edhe pjesën tjetër në rrugën për Gërmi
3 zyrën tjetër, që me pasë hapësirë për punë edhe me u mujt me
4 punu ma lehtë.

5 Py. Ju thatë se në Dardani ishte deri në vitin 1998, ku
6 punonte mjeku Shpetim. Kur filloi që të ekzistonte aty
7 domethënë kur u krijua zyra në Dardani?

8 Pë. Në Dardani u fillua në vitin 1998, në fillim të 1998-s.
9 Po ndërkohë prej atyhit kemi punu edhe ato tani janë nisë me u
10 vështirësu puna si i ndjeri Shpëtim Robaj dhe përfundoi në
11 mina me automjet edhe me disa staf punues përfundun në mina.
12 Edhe prej atyhi tani Prof. Dr. Jusuf Dedushaj vendosi që të
13 hapi edhe një zyrë rrugës për Gërmi. Kjo është e dyta, zyra e
14 dytë. Jusuf Dedushaj vendosi që të hapi në rrugën për Gërmi në
15 një shtëpi private.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
17 kur? Ju kërkoi ndjesë z. Avokat.

18 DËSHMITARI: Kjo ka ndodhë në vitin 1997 edhe 1998, pjesa
19 e dytë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
21 kur u krijua zyra e dytë?

22 DËSHMITARI: Zyra e dytë u krijua në 1998-n.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur
24 në vitin 1998?

25 DËSHMITARI: Në vitin 1998, kah fillimi - si mund ta quaj

1 - në fillim të marsit-prillit. Po besoj që më ka dalë mendsh.

2 S'më kujtohet saktësisht.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
4 ka problem. Në rregull.

5 Z. Avokat keni fjalën.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. Zyra në Dardani a vazhdoi që të ekzistonte apo nuk
8 ekzistoi më? Domethënë vazhduan njerëzit të punonin aty?

9 Pë. Pas vdekjes së të ndjerit Dr. Shpëtim Robaj, zyra në
10 Dardani u shpartallua dhe u mbyll ajo zyrë edhe kemi filluar
11 në rrugën për Gërmi që të çon ke zyra tjetër. Aty kemi
12 vendosun që të punojmë të gjithë se u bo një jetë shumë e
13 vështirë, shumë dinamike edhe fillun të tanë të punojnë me një
14 staf me të reduktushëm në zyrën për Gërmi, zyrën e Kryqit të
15 Kuq për Gërmi.

16 Py. Ju kuptojmë. Dua t'i kthehem edhe njëherë një pyetjeje.
17 Thatë se "Kryqi i Kuq Serb na pushoi nga puna."

18 Mund të na tregoni diçka më shumë për këtë? Pse?

19 Pë. Po Kryqi i Kuq neve si shqiptarë në vitin 1997 nga ka
20 larguar nga puna. Arsyeja pse ne ishim shqiptarë. Edhe na
21 largun neve nga puna të gjithë shqiptarëve. Ja nisën të
22 punonin vetëm sot ata edhe na u mbledhëm ne disa punëtorë që
23 ishim aty dhe me Jusuf Dedushën, me profesor Jusuf Dedushën
24 dhe vendosëm që të hapim q'to dy pika. Po pika e parë u mbyll
25 -- kjo pika te Gërmia për arsye se s'deshën Kryqi i Kuq serb

1 nuk dojke me ditun që na - me marrun vesh që na, populli
2 shqiptar shka po bojnë, na punëtorët e Kryqit të Kuq aty çka
3 po veprojnë ata, çka po bojnë ata. Për atë arsye na kanë largu
4 nga puna.

5 Py. Kryqi i Kuq Serb a vazhdoi që të ishte në punë në atë
6 kohë?

7 Pë. Kryqi i Kuq Serb - Kryqi i Kuq i Kosovës ka vazhduar
8 punën deri në vitin 1999.

9 Z. VON BONE: [Përkthim]

10 Py. A mund të na thoni pse ishte e rëndësishme, e nevojshme
11 që të krijohej Kryqi i Kuq i Kosovës përveç Kryqit të Kuq të
12 Serbisë.

13 Pë. Po ne si punëtorë me Jusuf Dedushën ne e kemi pa të
14 arsyeshme të hapim edhe ne Kryqin e Kuq të Kosovës për arsye
15 që t'ju dalim popullatës tonë shqiptare, që t'ju dalim në
16 ndihmë me gjana ushqimore, me veshmbathje, me shtrojë,
17 mbulojë, me barna, me ksi gjona çka i përkasin popullatës për
18 ndihmë.

19 Py. A nuk ishte e mundur që popullsia shqiptare t'i merrte
20 këto materiale që ju sapo i përmendët nga Kryqi i Kuq i
21 Serbisë?

22 Pë. Po nga Kryqi i Kuq i Serbisë nuk kanë mujtun me u furnizu
23 siç duhet. Po mendoj me shtrojë, mbulojë, me veshmbathje, me
24 qumësht për fëmijë me ksi gjona që i shpërndajshin. Ata s'kanë
25 mujtun me i marrë sado kudo me i marrë. Ose një arsye edhe i

1 urrejshin popullatën shqiptare.

2 Py. Kur e hapët zyrën - po më lër të bëj një pyetje tjetër.

3 Ju thatë që Shpëtimi vdiq. A e mbani mend se kur ka vdekur ai?

4 Pë. Dr. Shpëtim Robaj në mëngjes, në vitin 1998, u nisën për
5 në terren me staf për me shku me iu dalë në ndihmë popullatës,
6 të cilët kanë pasë nevojë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Dëshmitar.

9 Avokat, domethënë pyetja juaj ishte kur, kohën kur ka
10 vdekur Dr. Shpëtimi.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

13 Ademi, ju lutem përgjigjuni kësaj pyetjeje. Nuk është e
14 nevojshme që të na jepni të gjithë historinë, por jepini
15 përgjigje pyetjes që ju bëri Avokati.

16 Është një koment edhe që vlen edhe për pyetje të tjera
17 ky.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra ta përsëris edhe njëherë
19 pyetjen që ju bëra. Pyetja ime ishte kjo: "A e mbani mend kur
20 ka vdekur Dr. Shpëtimi?" Dhe kur flas "kur," e kam fjalën për
21 vitin, për muajin domethënë çfarë mund të mbani mend rreth
22 vdekjes së tij.

23 Pë. Dr. Shpëtim Robaj ka ndërruar jetë i ndjeri ne vitin 1988
24 [sipas dëshmitarit], po muaji nuk më kujtohet saktësisht.

25 Py. Në rregull. Duke iu kthyer përsëri zyrës së Kryqit të Kuq

1 të Kosovës që e hapët, e ngritët ju. Si i merrnit furnizimet
2 mjekësore? Nga kush i merrnit furnizimet me pajisje mjekësore?

3 Pë. Ne pajisjet mjekësore, këto i merrshim në pjesë të
4 donacioneve i cili ka çu një fond "Vendlindja Thërret" edhe
5 kemi pasun ne barnatore aty afër. Edhe aty ne i merrshim
6 barnat edhe prej donatorëve të tjerë kështu.

7 Py. Kur i kishit marrë këto materiale mjekësore të barnatore,
8 si shpërndareshin ato më tej?

9 Pë. Po këto barna, këto kur i merrshim në atë kohë prej
10 donatorëve, ne jemi kanun shtatë persona në atë kohë. Edhe i
11 merrshim ne vullnetarisht edhe i shpërndajshim nëpër zona të
12 ndryshme.

13 Py. A mund të na thoni se në çfarë zonash i shpërndanit
14 barnat? Na jepni disa shembuj të zonave ku i shpërndanit
15 barnat.

16 Pë. Barnat i kemi shpërnda nëpër zona të Drenicës, nëpër zona
17 të Llapit, të Gollagut, në Karadak edhe në Gjilan.

18 Py. Në qoftë se flasim për zonën e Drenicës, duke marrë
19 Prishtinën si pikë reference, a mund të na thoni se ku
20 shtrihet zona e Drenicës? Ku shtrihet Drenica në pjesën
21 lindore, veriore, perëndimore? Mund të na e thoni?

22 Pë. Drenica shtrihet domethënë në pjesën -- s'po di si ta
23 quaj atë. Më duket që është nga pjesa perëndimore, veriore mos
24 u gabofsha. Se kam telashe pak me këto perëndimore-veriore.

25 Py. E kuptoj këtë. Do t'ju bëj një tjetër pyetje.

1 Po zona e Gjilanit ku shtrihet? Në qoftë se do të marrim
2 Prishtinën si pikë reference, në çfarë drejtimi shtrihet kjo
3 zonë? Apo në drejtim të cilit fshati apo qyteti shtrihet kjo
4 zonë?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Avokat, sa për ta kuptuar unë, zona e Gjilanit. Nuk e di a e
7 përmendi dëshmitari këtë?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
10 tani e shikoj. Në rregull atëherë vazhdoni më tej.

11 DËSHMITARI: Qytetit i Gjilanit shtrihet në drejtim të
12 Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit në kufi me Serbinë.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]

14 Py. Në rregull, faleminderit. Shpërndarjet në këto zona si
15 realizoheshin në praktikë? Vinin njerëzit për t'i marrë apo
16 shkonit ju te njerëzit? Dhe a mund të na thoni sesi i
17 shpërndanit këto materiale?

18 Pë. Po. Shpërndarjen e kemi ba shumë me vështirësi na. Jemi
19 kanë, disa ne, disa ishin popullata aty tek zyrët tona i
20 merrshin. Edhe disa, shumicën e çojshim ne se u dashke me çu
21 barna, qumësht për fëmijë, pelena kështu. Deri afër shkojshim
22 me automjet afër, tani pjesën tjetër në këmbë me çanta në
23 shpinë tu i çu nëpër fshatra.

24 Py. A ishte e mundur që mbase ju t'jua jepnit këtu personave
25 të caktuar në mënyrë që ata të shkonin në drejtime të caktuara

1 për t'i shpërndarë? Ajo çfarë po mundohem të pyes është në
2 qoftë se ka pasur ndonjë grup personash që do t'i shpërndanin
3 këto materiale për ju në këto zona.

4 Pë. Po, ka pasun edhe persona të caktum të cilët kanë ardhun
5 tek ne i kanë marrun materialet dhe i kanë dërguar nëpër pikat
6 e tyne, nëpër fshatra, nëpër qytete te ndryshme.

7 Py. E kuptoj. Ju thatë që ishte shumë e vështirë që të
8 shpërndaheshin materialet. Së pari, le të përcaktojmë pak
9 kohën. A ka pasur ndonjë kohë konkrete kur u bë gjithmonë e më
10 e vështirë që të shpërndaheshin materiale të këtilla? Dhe nëse
11 po, për të cilën periudhë kohe flasim?

12 Pë. Koha më e vështirë ka qenë kur shkojshim nëpër terren
13 edhe s'kishim mundësi për t'i bartun gjanat, për t'i çuar si
14 duhet. Ka pasë vështirësi aty ka 1988-a [sipas dëshmitarit]
15 deri në 1999-a. Kemi pasë vështirësina të mëdhaja.

16 Py. A mund të na thuash më konkretisht se cilat ishin
17 vështirësitë apo çfarë e bënte kaq të vështirë që të
18 shpërndaheshin këto materiale në pikat përkatëse?

19 Pë. Po. Vështirësia për neve ka qenë se ne kemi punuar
20 ilegalisht si Kryqi i Kuq i Kosovës. Kemi punuar ilegalisht.
21 Dhe u deshke për t'i bartun materialet, për t'i ndihmuar. Po
22 kemi shkuar gjithmonë në mënyrë fshehurazi, se po të na
23 shikojshin, na nxajshin për shembull dhe na - policia serbe
24 ose ushtria serbe na nxajshin neve në rrugë, neve na
25 maltrajtojshin edhe kështu që u deshke me shku fshehurazi për

1 t'i dërguar ato pajisje nëpër pika.

2 Py. A ishte e mundur ne atë periudhë kohe që të bëhej
3 kontroll nga policia ushtarake apo nga ushtria - ju kërkoj
4 ndjesë - nga një urdhër i policisë ushtarake a ishte e mundur
5 të kontrolloheshit - që njerëzit do të ishin më hezitues që
6 t'i merrnin këto materiale dhe të shkonin diku? Domethënë
7 çfarë lloj rreziku do të kishin njerëz të tillë? Me çfarë lloj
8 rreziku do të përballëshin ata?

9 Pë. Po edhe ata vullnetarët të tanë, të cilët kanë qenë në
10 terren edhe ne kemi pasë vështirësi se s'kemi pasë mjete si
11 duhet për t'i dërguar ato nëpër pika të caktume se jemi,
12 gjithmonë jemi tutur nga policia serbe. Kemi shku deri aty për
13 t'i dërguar sendet fshehurazi për mos me na pa policia ose
14 këta çka po çojmë na barna ose veshmbathje ose qumësht, pelena
15 tu i shpie për popullatë. Domethënë krejt fshehurazi i kemi
16 dërgu ato, kurrë s'kemi guxur me shkue, me kanun të ç'lirë që
17 me u shkue me i dërgu ato pa frikë, po gjithkund me frikë jemi
18 shku.

19 Py. Gjatë asaj periudhe a kontrolloheshin njerëzit?

20 Pë. Po, janë kontrolluar. Popullata u kontrollojke nëpër
21 rrugë, nëpër asi. Mu më kanë kontrollu, më kanë ndalun, më
22 kanë pytun. Mu më kanë rreh në mes të rrugës e kështu.

23 Py. A e mbani mend, i mbani mend bombardimet e NATO-s të
24 vitit 1999?

25 Pë. Në vitin 1999, bombardimet kanë fillu mos gabofsha më

1 datën 23-24 q'aty dikun, aty për afërsisht më 23 apo 24, nuk
2 jam bash i saktë cilën ditë. Në mars.

3 Py. Duke folur për këtë kohë, a u bë edhe më e vështirë pas
4 bombardimeve të NATO-s që materialet të çoheshin në vendin e
5 destinacionit të synuar?

6 Pë. Po, gjithsesi janë konë më të vështira si ia fillojnë
7 bombardimet NATO-ja, policia dhe serbët u agresuan - si ta
8 quaj atë - u banë më nervozë kështu edhe ne e kishim ma të
9 vështirë për të dalun nëpër terren e për të dalun në ksi
10 gjana.

11 Py. Ju thatë që forcat serbe u inatosën. Si e dini këtë gjë?
12 Nga e dinit ju këtë gjë? Si mund të vërehej? Si mund të vihej
13 re një gjë e tillë?

14 Pë. Po u vërejtën menjëherë se fillun bombardimet e NATO-s,
15 granatimet, ato. Edhe policia dhe ushtria serbe u janë marrun
16 një farë inatosje, një farë - si ta quaj atë - u inatosën
17 shkurt, më agresore neve - unë mund ta quaj - mu duk kështu si
18 agresiv ndaj popullatës tonë, të cilët i kanë zanun ata me
19 rrehje, me sharje, me thyrje, me kështu.

20 Py. Përveç kësaj, çfarë dëgjonit nga njerëzit? Çfarë ju
21 thonin njerëzit rreth kësaj gjëje kur vinin në zyrën tuaj? A
22 ju thonin ata se çfarë u kishte ndodhur atyre?

23 Pë. Zakonisht popullata kur vike në atë kohë - gjatë
24 bombardimeve më popullata s'ka ardhun te Kryqi i Kuq. S'kanë
25 guxu për të ardhë te zyrat e Kryqit të Kuq. Arsyeja se kanë

1 frikë se afër e kemi pasë edhe pikën - qysh si ta quaj - një
2 pikë policore, e cila ka qenë afër zyrave të Kryqit të Kuq.
3 Edhe tani popullata kishte frikë me ardhë aty për të marrë
4 gjana që iu nevojitshin. Po kemi dëgju fjalë të ndryshme, të
5 tutur, rrahje, ksi sende.

6 Py. Ju thatë që kishte një pikë policie, që ishte në afërsi
7 të zyrave. Kur ju duhej që të kalonit këtë pikë kontrolli,
8 çfarë përjetonit juve? Çfarë ju duhej që të kalonit?

9 Pë. Po ne në atë kohë kur ja nisëm atë, shumicën e kohës na u
10 deshke me shkue, unë për vete, kam shkue prej shtëpisë në
11 shtëpi, prej oborrit ne oborr. Kemi shku deri te pika e Kryqit
12 të Kuq të Kosovës fshehurazi se s'kemi guxu për të dalun në
13 rrugë kryesore, ku ka qenë policia. Po kemi shkue në shtëpi
14 pas shtëpie, oborr pas oborri deri te zyrat e Kryqit të Kuq.
15 Është fjala gjatë bombardimeve.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Avokat, a morët përgjigje për pyetjen tuaj? Kam përshtypjen që
18 pyetja kishte të bënte me postbllokun, me punktin e policisë
19 apo jo?

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Në fakt mendoj që përgjigjen e
21 mora për pyetjen time sepse ai tha që ishte shumë e vështirë
22 që të shkoja në zyrën, të shkonte në zyrën e tij.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 "Çfarë përjetonit ju kur ju duhej që të kalonit një punkt të
25 tillë policie?"

1 Z. VON BONE: [Përkthim]

2 Py. A ju është dashur ndonjëherë që të kalonit këtë punkt
3 vetë? Ose në qoftë se jo, pse e shmangnit kalimin e një punkti
4 të tillë?

5 Pë. Po atij punkti iu deshte me iu shmangur se po të
6 shkojshim ne për atë rrugë, të nxajshin, t'i marrshin sendet,
7 të hallaktshin, t'i marrshin sendet edhe besa-besë të rrehshin
8 ose kanë mujt edhe me të mbytë. Për atë arsye u deshke me u
9 shmangur e me shku nëpër oborre, nëpër rrugica, nëpër --
10 fshehurazi për t'iu larguar asaj pikës policore ose pikë
11 kontrolli të policisë që u hallakatshin aty.

12 Py. Në Prishtinë, a kishte shumë pika kontrolli të tilla?

13 Pë. Po, ka pasun. Ka pasun te shkolla teknike si e quajmë ne,
14 ka pasun te rruga që shkon për - i thojmë ne nga Xhamia e
15 Llapit - aty ka pasun nga një. Po ka pasun pika të ndryshme.
16 Ka pasun boll, ka pasun pika të policisë, punkte.

17 Py. A e bënte kjo më të vështirë furnizimin me materialet për
18 personat, të cilët kishin nevojë për to?

19 Pë. Po, sigurisht që më e vështirë ka qenë, se ndryshe me
20 shkue rrugicave për t'ju larguar punkteve, pikave kryesore ku
21 ishin të stacionum policia serbe dhe ushtria. U deshke me
22 shkuar rrotullazi për me shku me u furnizu ose me dërgu q'atë
23 material në vendin e duhur, ku e kemi pasë destinacionin.

24 Py. Ju thatë që nuk kishit mënyra transporti, mjete
25 transporti. A do të thotë kjo se pjesa më e madhe e këtyre

1 materialeve dërgoheshin duke shkuar në këmbë?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat, ju lutem formuloni pyetjet në mënyrë të tillë që të
4 mos përmbajë dhe përgjigjen pyetja. Dhe kemi vënë re që bëtë
5 disa pyetje të kësaj natyre, ju lutem.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. Pra pyetja ime ishte, ju nuk kishit mjete transporti. Si
8 siguronit që materialet dërgoheshin në pikën e destinacionit?

9 Pë. Në përmes vullnetarëve janë shpërnda. Transport s'kemi
10 pasë fare, vetëm një koleg, ajo ka pasë një automjet, pela -
11 s'di çfarë automjeti ka pasë. I vetmi ai u kanun. Vinke i
12 marrke me automjet, i çojke deri afër, afër tani në shpinë, me
13 çanta nëpër shpina i kemi dërguar pajisjet, gjanat ushqimore
14 me çanta nëpër shpinë, nëpër fusha, male i kemi dërgu nëpër
15 fshatra të ndryshme.

16 Py. Kur shkonit në zona këtë e bënit gjatë ditës, gjatë natës
17 domethënë kur ishte momenti më i përshtatshëm për të dërguar
18 materialet?

19 Pë. Po para bombardimeve shkojshim edhe ditën. Edhe gjatë
20 ditës shkojshim deri në mbramje, i çojshim pajisjet. Edhe në
21 mbramje u kthejshim nëpër shtëpiat tona.

22 Py. Po pas sulmeve të NATO-s? Atëherë pyetja ime ishte që si
23 ishte situata pas bombardimeve të NATO-s?

24 Pë. Situata pas bombardimeve të NATO-s ka qenë shumë e
25 vështirë se u deshke me i mbajton nëpër shpinë çantat me

1 materiale të ndryshme në shpinë edhe me i çue me vullnetarë,
2 me njerëz, me popullatë, e cila i ka ardhë i ka marrë ato dhe
3 kanë shku në - i kanë marrë edhe i kanë çu në turra në shpinë
4 i kanë çue. Dikund u bojke një turrë, po vike 30 deri në 40 kg
5 e randë me pajisje të ndryshme, me gjana, me ksi sendesh për
6 t'i dërguar nëpër pika ku kishin nevojë popullata.

7 Py. A keni pasur vetë juve probleme me policinë serbe sa i
8 takon shpërndarjes së materialeve?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Avokat, a morëm përgjigjen për pyetjen që bëtë se sikur nuk e
11 dëgjova përgjigjen? Thjesht dëgjova një deklaratë sa i takon
12 peshës së çantave të shpinës. Por pyetja juaj ishte pas
13 sulmeve ajrore të NATO-s, kur?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Është e vërtetë. Është më e
15 vështirë sesa kaq të paktën, megjithatë ta bëj dhe njëherë
16 pyetjen.

17 Py. Pra, pas bombardimeve, furnizimet dërgoheshin ose
18 shpërndarjet e materialeve bëhen prapë gjatë ditës apo jo?

19 Pë. Gjatë bombardimeve gjatë ditës kemi bo shpërndarje. Mu
20 personalisht më ka ndodhun në fshatin Shalë, Komuna e
21 Drenasit, duke bartun me turra dikund ka afër 30 kile në
22 shpinë i kam pasun, kur tu shku në kodër kështu tejposhtë na
23 kanë pa forca serbe, na kanë shti, gjujt me armë të tyne. Prej
24 tutës e kam hedh çantën edhe jam rrëzue, jam shku kështu
25 kodrës tejposhtë tu shkue edhe e kam thy kambën edhe q'ashtu

1 zvarrë afër nja 15 minuta mos gabofsha, q'ashtu zvarrë tu shku
2 në atë - me mundësitë e mia deri në shpi afër fshatit në shpi,
3 shpi private. Aty jam pozicionue.

4 Kemi pasë vështirësina të mëdhaja.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
6 z. Avokat, një moment ju lutem.

7 Do t'ia bëj unë një pyetje dëshmitarit.

8 Z. Ademi, kur ju bëhet një pyetje, ju lutem përpiquni t'i
9 përgjigjeni drejtpërdrejt pyetjes dhe vetëm pyetjes, sepse -
10 ne ju falënderojmë për dëshminë tuaj - por njëkohësisht po na
11 thoni dhe shumë gjëra, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me
12 pyetjet, të cilat po jua bën Avokati i Mbrojtjes.

13 Nëse ju bëhet pyetja për shembull, pas sulmit ajror të
14 bombardimeve pra, e bënit jo vetëm gjatë ditës por edhe në
15 momente të tjera. Vetëm kësaj pyetjeje mund t'i përgjigjeni,
16 po flasim për kohën kur ka ndodhur gjatë ditës, më mbrëmje,
17 natën.

18 Tani unë fjalën unë do t'ia jap prapë Avokatit Mbrojtës
19 që t'jua bëj pyetjen, por desha t'ju rikujtoj që të tregoni
20 vëmendje për pyetjen dhe t'i përgjigjeni vetëm pyetjes.

21 Z. VON BONE: [Përkthim]

22 Py. Atëherë edhe njëherë t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje, pas
23 sulmeve ajrore, cili ishte momenti më i mirë i ditës për t'i
24 bërë këto furnizime, për t'i çuar këto materiale? Kur e bënit
25 dhe në ç'moment të ditës apo të natës? Vetëm kaq.

1 Pë. Po, e bënim ditën. Ka ndodhë edhe natën kemi pa dërgimin
2 e tyre, këtyne pajisjeve. Shumicën ditën edhe natën. Na kanë
3 nuanë edhe natën, na kanë nuanë kohën deri kur kemi dërgu
4 sendet.

5 Py. Sapo thatë diçka pak më përpara, cekët që ju ka ndodhur
6 diçka, nuk e di a kishit në shpinë, një torbë, një çantë
7 shpine - nuk e di se ku e lexova...

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
9 në faqen 23, rreshti 8 [sipas përkthimit].

10 Z. VON BONE: Po.

11 Py. Sapo cekët se çfarë ju ndodhi në fshatin Shalë. Gjëra të
12 tilla a ju kanë ndodhur edhe kolegëve tuaj, të cilët punonin
13 në zyrën e Gërmisë? A mos ju kanë treguar mbase që ju ka
14 ndodhur një gjë e tillë apo mund të keni dëgjuar histori të
15 ngjashme prej tyre?

16 Pë. Po, kam dëgju, po si zakonisht sikur mu që më ka ra fati
17 i keq, mue, të tjerët kolegë e kanë pasun diqysh si ma me
18 lehtësim. Shyqyr prej Zotit që atyne s'ju ka ndodhë kurrë ma
19 e keqe. Vështirësi kanë pasë edhe ata.

20 Py. Me çfarë lloj vështirësish përballëshin ata?

21 Pë. Të udhëtimit, të peshës dhe i kanë çue nëpër rrugë dhe i
22 kanë çue pajisjet nëpër vende. Kanë pasë vështirësi.

23 Py. A ka ndodhur ndonjëherë që iu janë konfiskuar këto
24 mallrat, gjërat që kishin me vete?

25 Pë. Për sa e di unë jo, se s'kanë mujtun me u konfisku ato se

1 s'kanë pasun arsye. Diçka të mëdhaja kështu. Ka pasë barna,
2 veshmbathje, ksi sende, qumësht, pelena, sende humanitare ka
3 pasun. Po nuk besoj që ka ndodhur të konfiskume kështu diçka.
4 Ndoshta asi po s'më kujtohet saktësisht.

5 Py. Mirë. Kur po flisnit më herët për shpërndarjen, thatë
6 edhe se çoheshin, dërgoheshin edhe në zonën e Gollakut. Ku, në
7 ç'vend të Gollakut dërgoheshin?

8 Pë. Në Gollak vijshin njerëzit i marrshin vullnetarët i kanë
9 marrun ato. Ndër ta kanë qenë vullnetarët i marrshin edhe i
10 çojshin nëpër pika të tyne, në fshatra të popullatës anej
11 nëpër Gollak, nëpër këtë kolegji, këtë shkollë, Llukar. Anej na
12 i merrshin vullnetarët edhe i kanë çue anejna.

13 Py. Pas sulmeve ajrore, a vutë re zhvendosje të njerëzve,
14 dale të tyre për shembull largim të njerëzve nga shtëpitë e
15 tyre në Prishtinë?

16 Pë. Po, ka pasun zhvendosje të popullatës deri një pjesë prej
17 një lagje në një lagje tjetër, prej një lagje, lagje tjetër.
18 Si për shembull në lagjen time u bënë popullata shumë e madhe.
19 Se tu ardhë prej lagjeve të tjera u bënë popullata shumë e
20 madhe edhe u frigojshin, u frigojshin se në atë e bombardojke
21 policia sulmojshin, maltrajtojshin, ksi gjana.

22 Py. Po raste të tjera ka pasur që ju të jeni maltrajtuar nga
23 policia?

24 Pë. Po, siç e thashë më herët ka pasur një rast kur më kanë
25 nuanë mu edhe më kanë rrehun edhe si duket 50 euro m'i kanë

1 pasë marrun, 50 marka në atë kohë. Edhe më rrehën edhe mi
2 morën edhe më thojshin pse po mban ti marka kurse që këtu je
3 në Serbi. Këtu nuk janë këto valutat tona. Parja jonë është e
4 Serbisë kështu që unë e kom hongër edhe rrehjen edhe mi kanë
5 marrë 50 marka në atë kohë.

6 Py. Kur ka ndodhur kjo? Ju kujtohet? Para sulmeve ajrore apo
7 pas sulmeve ajrore? Në ç'moment kohor ka ndodhur?

8 Pë. Kjo ka ndodhë si duket para sulmit ajror.

9 Py. Çfarë ndodhi? Mund të na e shpjegoni.

10 Pë. Po më rrehën, më maltrajtun, mi morën ato të hollat edhe
11 më lirun ndërkohë. Më lirun edhe shkova vazhdova punën prapë.

12 Py. Keni marrë ndonjë ndihmë asokohe nga Komiteti

13 Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq? Kishte kontakte midis jush si
14 Kryqi i Kuq i Kosovës dhe Kryqit të Kuq Ndërkombëtar?

15 Pë. Po në atë kohë neve si Kryqi i Kuq i Kosovës, Kryqi i Kuq
16 Ndërkombëtar nuk na ka njoftun zyrtarisht për arsye se ka
17 ekzistuar Kryqi i Kuq serb, i Serbisë këtu në Kosovë. Po kohë
18 pas kohe na dhajshin donacione na dhajshin ksi barna e fasha e
19 pelena, ksi gjana për popullatën.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] M;
21 lejoni t'ju ndërpres z. Avokat.

22 Z. Prokuror, ju vura re që pakëz më përpara po qëndronit
23 më këmbë. Dëshironi të merrni fjalën?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse. Në një
25 moment do të doja t'i kërkoja Avokatit që të bënte pyetje më

1 të qarta, për shembull, ai bëri pyetjen çfarë ndodhi asokohe
2 dhe nuk ishte e qartë se çfarë i ndodhi dëshmitarit asokohe
3 apo çfarë ndodhi asokohe në Prishtinë pasi filluan sulmet
4 ajrore të NATO-s. Nuk ishte pra shumë e qartë por përgjigjja u
5 dha ne kontekst që i ndodhi dëshmitarit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë e
7 lejova pyetjen, sepse u kuptua që ishte një pyetje pasuese nga
8 pyetja e mëparshme.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nëse kështu e kanë kuptuar të
10 nderuar Gjykatës atëherë nuk ka problem, faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
12 Avokat mund të vazhdoni.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]

14 Py. Kur ndodhën sulmet ajrore të NATO-s, ju vetë mund të
15 vazhdonit të jetonit në shtëpinë ku banonit asokohe?

16 Pë. Po, kam banue po me vështirësi. Në një moment kanë pasë
17 ardhun forcat policore edhe ma kanë maltrajtuar grunë edhe
18 djalin 4 vjeç që e kam pasë, që e kam ende. Edhe prej frikës
19 kam hyp në çati edhe prej çatisë i shikojsa. I shikojsa tu
20 maltrajtu grunë, familjen. Edhe prej asaj kohe djalin e kam si
21 me thanun jo mirë me shëndet mendor prej traumave.

22 Py. Mesa kuptoj kjo ka ndodhur pas sulmeve ajrore të NATO-s.
23 Sa kohë kishte kaluar nga sulmet ajrore ju kujtohet?

24 Pë. Po e di që dikund ka fundi i marsit të '99-s q'aty. Ose
25 ka mesi i marsit q'aty. S'më kujtohet saktësisht bash.

1 Py. Po, së pari, a jeni i sigurt që ka ndodhur mbas sulmeve
2 ajrore?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
4 Dëshmitar, mund t'i hiqni ndëgjueset ju lutem, hiqini
5 ndëgjueset. Hiqini, hiqini ndëgjueset.

6 Z. Ademi, hiqini, hiqini nga veshët ndëgjueset. Mos i
7 mbani më në kokë.

8 Z. Prokuror, keni fjalën. E kuptoj edhe pyetjen tuaj.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, problemi
10 është që në faqen 28 të transkriptit shohim se pyetjes se kur
11 ka ndodhur, pra rrahja e bashkëshortes dhe e fëmijës së
12 dëshmitarit, përgjigjja në rreshtin 6 deri në rreshtin 7
13 është: "Me sa di diku nga fundi i marsit të vitit '99-të duket
14 apo mbase nga mesi i marsit. S'jam fort i sigurt."

15 Besoj se kjo ishte përgjigjja e dëshmitarit. Mirëpo
16 pyetja përpara ishte, a ka ndodhur pas sulmeve të NATO-s. Pak
17 a shumë kjo ia jep idenë dëshmitarit sesi duhet t'i
18 përgjigjet. E kemi të zezë mbi të bardhë në procesverbal. Ky
19 është kundërshtimi im, e nderuar Gjykatëse për pyetjen që ka
20 bërë Avokati.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit, z. Prokuror.

23 Z. Avokat, unë e kuptoj atë që thotë Prokurori. Mund të
24 bëni pyetje të hapura por siç jua thashë edhe më përpara
25 përpiquni që të mos përfshini në pyetjen tuaj dhe përgjigjen

1 që mendoni se do të japë apo duhet të japë dëshmitari.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Po përgjigjja ishte diku nga
3 fundi i marsit të vitit '99-të. Dhe pastaj thotë në mes të
4 vitit '99-të më herët thotë që sulmet ajrore kanë filluar më
5 23 apo 24 mars dhe unë thjesht desha të sigurohesha nëse kjo
6 ka ndodhur përpara apo pas fillimeve të sulmeve ajrore. Kjo e
7 gjithë sepse - kjo ka të bëjë me sqarimin e kohës, për të
8 cilën flet dëshmitari.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po me
10 sa duket ai nuk e di me saktësi.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Prandaj edhe unë po e pyes.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Patjetër po jo duke i bërë pyetje, e cila ia jep përgjigjen
14 gati.

15 Mbase mund t'ia bëni në mënyrë të hapur ose mund të bëni
16 pyetjen duke përdorur një pikë referimi në kohë. Kështu duhet
17 formuluar.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Z. Dëshmitar -

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Avokat, prisni njëherë t'i them unë dëshmitarit të vendosë
22 ndëgjueset pastaj.

23 Z. Dëshmitar, më dëgjoni në rregull?

24 DËSHMITARI: Po. Po, zonjë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

1 Po diskutonim për pyetjen që do t'jua bëjë Avokati, sepse nuk
2 donim që të ndikonim tek përgjigjja juaj prandaj dhe ju
3 kërkuam që t'i hiqnit ndëgjueset nga koka. Mund t'ju kërkojmë
4 edhe në të ardhmen, në një moment tjetër për të njëjtën gjë.
5 Më kuptoni?

6 DËSHMITARI: Po, znj. Gjykatëse, s'ka problem.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
8 rregull.

9 Z. Avokat, vazhdoni.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]

11 Py. A ju kujtohet se kur ka ndodhur ky incidenti në shtëpinë
12 tuaj?

13 Pë. Incidenti ka ndodhur ma merr mendja, mos gabofsha dikund
14 para, gjatë bombardimeve. Gjatë bombardimeve ka ndodhë kur
15 janë ardhun policia dhe ma kanë rreh gruan edhe fëmijën edhe
16 familjen etj. me do sopatëz të vogël kështu.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Avokat, mbas 10 minutash shkon ora 11.00 kështu që duhet ta
19 mbani parasysh.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshiroj që t'ia rifreskoj
21 kujtesën dëshmitarit. Për këtë dëshiroj që të nxjerrim në
22 ekran, faqen 5 të deklaratës së dëshmitarit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Avokat, po mbase është më mirë ta bëni njëherë pyetjen dhe
25 nëse nuk i kujtohet, atëherë sigurisht që mund t'ia

1 rifreskojmë kujtesën.

2 Po bëni njëherë një pyetje, pastaj të shikojmë. Që t'i
3 nxjerrim dokument nuk më duket e logjikshme pa i bërë pyetje.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po unë sikur ia bëra një pyetje,
5 e nderuar Gjykatëse dhe dëshmitari foli për këtë incident dhe
6 në një moment është disi e ndryshme përgjigjja nga deklarata
7 që ka dhënë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Avokat, prisni pak.

10 Z. Ademi, hiqini ndëgjueset, ju lutem. Faleminderit.

11 Z. Avokat, mbase ka një keqkuptim. Ju thatë që, "dëshiroj
12 që t'ia rifreskoj kujtesën" por nuk e kuptova se për çfarë e
13 kishit fjalën, sepse doli krejt papritur, sepse është
14 diskutuar, thatë. Por nëse ju thoni, përmendni se çfarë është
15 diskutuar që mund të ketë dhënë përgjigje të ndryshme, atëherë
16 mund të vendosim deklaratën.

17 Po për tani, he për he nuk e kam të qartë.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Incidenti për të cilin e kam
19 fjalën, është ajo që i ka ndodhur familjes së tij, që ai u
20 ngjit lart në çati. Unë e pyeta dëshmitarin për këtë incident
21 dhe ai foli diku nga fundi i marsit në fillim, pastaj tha në
22 mes të marsit, prandaj dhe unë desha që t'ia rifreskoj
23 kujtesën sepse në deklaratë më duket ka qenë e qartë se ka
24 ndodhur pas bombardimeve të NATO-s, po të shohim deklaratën e
25 tij.

1 Pra për të qenë - për ta bërë të qartë këtë, unë desha që
2 të nxjerr këtë pjesë të deklaratës, për t'ia rifreskuar kështu
3 kujtesën.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Avokat, tani ju e bëtë të qartë se në ç'kontekst dëshironi
6 t'ia rifreskoni kujtesën dëshmitarit. Mund të vazhdoni po së
7 pari do t'i kërkoj dëshmitarit që të vendosë ndëgjueset.

8 Z. Ademi i vendosi ndëgjueset.

9 Z. Avokat, mund të vazhdoni.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkoj që të nxjerrim në ekran
11 deklaratën e dëshmitarit, është në faqen 5 të deklaratës, në
12 paragrafin e dytë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
14 të jepni numrin ERN?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Një moment sa ta gjej.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos e
17 keni fjalën për numrin DSN00680 [sipas përkthimit] është në
18 shqip. Po atë në anglisht e doni?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe versioni shqip të tij.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
21 me numër DSM00452 dhe DSM00608.

22 Z. Sekretar, është në rregull? Ju mjafton?

23 Në rregull.

24 Z. VON BONE: [Përkthim]

25 Py. Z. Dëshmitar, do t'ju citoj një përgjigje. Pyetja që ju

1 kam bërë unë:

2 "Nga momenti i bombardimeve të NATO-s, ku ke jetuar? Dua
3 të them ku rrije dhe ku e kaloje natën."

4 Dhe këtu ke thënë:

5 "Rrija një natë në shtëpinë time. Herët e tjera në
6 shtëpinë e vëllait, të dyja shtëpitë në Prishtinë. Një ditë,
7 policia serbe më erdhi në shtëpi, ma rrahën gruan dhe djalin
8 4-vjeçar në oborr. Unë isha nën çati e nuk isha në gjendje të
9 bëja asgjë për këtë. Kjo ka ndodhë pas bombardimeve të NATO-
10 s."

11 Tani kam një pyetje për ju: Tani që jua lexova këtë pjesë
12 nga deklarata juaj, a ju është rifreskuar kujtesa, ju kujtohet
13 më mirë?

14 DËSHMITARI: Po, unë të thashë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Ademi,
16 prisni pakëz. Edhe njëherë t'i hiqni ndëgjueset.

17 Z. Prokuror.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Unë nuk kam kundërshtim për
19 pyetjen dhe për paraqitjen e deklaratës por unë i lutem
20 Gjykatëses që ta heqë deklaratën nga ekrani sepse pjesa tjetër
21 ka të bëjë me gjëra të cilat ende nuk janë paraqitur në
22 dëshmi.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
24 pajtohem me këtë.

25 Z. Sekretar, ju lutem mund ta hiqni. Po.

1 Z. Avokat, vazhdoni.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Z. Dëshmitar, unë sapo jua lexova
3 këtë paragraf, a jua rifreskon?

4 Z. Dëshmitar, sapo jua lexova pyetjen që jua kisha bërë
5 atëherë dhe përgjigjen që ju më dhatë për atë pyetje. E kam
6 fjalën për atë ditën apo atë kohën kur ka ndodhë ky incidenti.
7 Pyetja që kam: A ju kujtohet më mirë tani?

8 Pë. Po. z. Avokat më kujtohet tash.

9 Py. Mirë, në rregull.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mbase ky
11 është momenti më i mirë për të ndaluar.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
13 po unë nuk e kam të qartë që po, i kujtohet më mirë. Kështu
14 tha dëshmitari që "më kujtohet më mirë." Po çfarë?

15 Z. VON BONE: [Përkthim]

16 Py. A është e vërtetë se ky incident ka ndodhur siç e thoni
17 dhe në deklaratën tuaj, që ky incident ka ndodhur pas
18 bombardimeve të NATO-s?

19 Pë. Po, plotësisht jam i bindur që ky incident ka ndodhë pas
20 bombardimeve të NATO-s. Edhe ndërkohë kanë ardhun pjesëtarë të
21 UÇK-së, tre persona na kanë vizituar.

22 Py. Z. Dëshmitar, pyetja ishte jo kur ju erdhën tre anëtarët
23 e UÇK-së. E kam fjalën për incidentin që i ka ndodhë familjes
24 tuaj në oborr të shtëpisë. Ky incident a ka ndodhur pas
25 sulmeve të NATO-s, sulmeve ajrore të NATO-s në Kosovë?

1 Pë. Incidenti ka ndodhë gjatë sulmeve, gjatë sulmeve të NATO-
2 s.

3 Py. Ju kuptoj. Pra në deklaratën që na e keni dhënë asokohe,
4 aty keni thënë, pas sulmeve, pas bombardimeve të NATO-s, sot
5 po thoni gjatë bombardimeve të NATO-s. A mund të shpjegoni, si
6 e shpjegoni këtë ndryshim në përgjigje.

7 Py. Z. Avokat, ekziston mundësia se është ba edhe një kohë e
8 gjatë prej atëherit edhe s'më kujtohen edhe fort, fort gjanat.
9 Ekziston mundësia që edhe pas ose gjatë ekziston mundësia që
10 edhe pas bombardimeve ose para. Po s'më kujtohen fort, fort
11 saktësisht gjanat. Kam harru, është kohë e gjatë. Po ndoshta e
12 kam thanun ashtu.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
14 do të thosha që përgjigjja është e qartë.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Kështu mendoj dhe unë.

16 Mendoj se është dhe momenti i përshtatshëm për të bërë
17 pushimin.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit, z. Avokat.

20 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqërohëni dëshmitarin
21 të dalë nga salla.

22 Z. Ademi, do të bëjmë një pauzë gjysmë ore dhe pastaj do
23 t'ju thërrasim që të ktheheni prapë këtu mbas gjysmë ore që të
24 vijojmë me dëshminë tuaj.

25 DËSHMITARI: Në rregull.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
3 bëjmë ndërprerjen tani dhe do të rifillojmë pas 30 minutash.

4 --- Pauza fillon në orën 11.01

5 --- Seanca rifillon në orën 11.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë. Tani të shohim të pranishmit në sallë dhe shoh që kemi
8 të njëjtën përbërje të ekipeve, siç kishim edhe më përpara.
9 Kjo përmendet për procesverbal.

10 Përpara se sa të futet dëshmitari në sallë do të doja që
11 të ngrija një çështje të vogël që ka të bëjë me kërkesën e
12 përbashkët. Trupi Gjykes vëren që kërkesa e përbashkët e ZPS-
13 së e cila sugjeron parashtrimin e dokumenteve dhe duhet
14 vërejtur gjithashtu që dëshmia e këtij dëshmitari ka
15 përfunduar brenda marsit të vitit 2022. Trupi Gjykes vëren se
16 në pajtim me paragrafin 37 të Vendimit për Zhvillimin e
17 Procedurave, parashtrimi i protokolluar nr. 170 duhet që të
18 dorëzohet deri ditën e fundit të dëshmisë së dëshmitarit.

19 Megjithatë duke marrë parasysh zhvillimet e fundit, Trupi
20 Gjykes mendon që ZPS-ja dhe Mbrojtja kanë treguar arsye
21 bindëse për kërkesën, në pajtim me rregullën 95(a) [sipas
22 përkthimit], kështu që Trupi Gjykes pranon shtyrjen e afatit
23 të dorëzimit të këtij parashtrimi me datën 8 prill të vitit
24 2022, që është ditë e premte.

25 Zonja Sekretare e seancës, a mund ta sillni dëshmitarin

1 në sallë, ju lutem?

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
4 se erdhët.

5 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Avokat, jam e informuar që keni përdorur 1 orë e 15 minuta të
8 kohës në dispozicion. Tani keni fjalën, në mënyrë që të mund
9 të vazhdoni më tej me marrjen në pyetje.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar
11 Gjykatëse.

12 Py. Z. Dëshmitar, ju thatë më parë sot - për procesverbal,
13 kjo gjendet në faqen 18, rreshti 24 - që:

14 "Në vitin 1999, në qoftë se nuk e kam gabim, sulmet
15 ajrore kanë filluar me 23 dhe 24 mars..."

16 Pyetja ime është kjo: për të qenë të qartë plotësisht,
17 nuk ka ndodhur atë ditë incidenti që përmendët me familjen
18 tuaj, domethënë nuk ka ndodhur as me 23 as me 24 mars, apo jo?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
20 lutem hiqni dëgjueset, z. Dëshmitar.

21 E shikoj që jeni ngritur në këmbë, z. Prokuror, e keni
22 fjalën por ndoshta kemi të njëjtën gjë për të thënë.
23 Megjithatë e keni fjalën.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Së pari, pyetja është
25 orientuese.

1 Së dyti, dëshmitari përpara pushimit e dha përgjigjen e
2 vet dhe kjo përgjigje mund të gjendet në faqen 35 në rreshtat
3 3 dhe 7 dhe për rrjedhojë kjo pyetje duhet konsideruar si =kur
4 u bë dhe mori përgjigje.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit, Prokuror.

7 Avokat, nuk do t'ju lejojmë që ta bëni këtë pyetje, sepse
8 e kemi diskutuar plotësisht përpara pushimit, kështu që ka
9 marrë përgjigje.

10 Ju lutem, vazhdoni me pyetjen tjetër.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, dua ta bëj
12 këtë pyetje. Do t'ju them edhe arsyet pse. Sepse është fjala
13 gjatë sulme ajrore. Dhe kjo fjalë mund të mos jetë e qartë.
14 Mund të jetë konfuzuese dhe mund të zgjasë, për shembull, deri
15 në qershor të vitit 1999 kur thua "gjatë". Dhe arsyeja se pse
16 e bëra pyetjen është që dua ta bëj të qartë që përgjigja e
17 dëshmitarit është që kur thotë "gjatë sulmeve" ne të mos e
18 kuptojmë këtë gabimisht që kjo ka ndodhur në atë ditë kur kanë
19 ndodhur sulmet ajrore, domethënë, që familja e tij është
20 sulmuar gjatë ditëve kur kanë ndodhur sulmet ajrore të NATO-s.

21 Pra, dëshmitari tha më përpara që kjo ka ndodhur drejt
22 fundit të marsit. Por në mënyrë që të shmangim keqkuptime të
23 mundshme lidhur me këtë, unë dua të kem mundësinë që t'i bëj
24 këtë pyetje në mënyrë që të përjashtoj mundësinë që incidenti
25 nuk ka ndodhur me 23 dhe 24 mars. Pra sulmet ajrore të NATO-s

1 kanë filluar me 23 dhe 24 mars. Këta tha dëshmitari. Më
2 përpara ai tha "drejt fundit të marsit" dhe për këtë arsye
3 doja që ta kuptonim se kur ka ndodhur incidenti me familjen,
4 pra, që incidenti me familjen nuk ka ndodhur me këto dy data.

5 Në qoftë se Prokurori e kupton në të njëjtën mënyrë,
6 domethënë që nuk bëhet fjalë për datën 23 dhe 24 kur ka
7 ndodhur ky incidenti, atëherë nuk ja vlen që unë ta bëj këtë
8 pyetje.

9 Por, thjesht dua që të sigurohemi që jemi në të njëjtën
10 linjë, në mënyrë që të mos kemi interpretime të ndryshme
11 lidhur me përgjigjen për këtë pyetje.

12 Kjo është arsyeja pse dua ta bëj pyetjen.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
14 t'ju kuptoj se në fund është shumë e rëndësishme se çfarë
15 kuptojnë palët dhe pjesëmarrësit nga deklarata, por në fund
16 jemi ne ata që e vendosim. Domethënë është e rëndësishme deri
17 në një nivel të caktuar.

18 Z. Prokuror, e kërkoni fjalën sërish?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
20 Gjykatës, unë nuk do të sugjeroj se si do të formulohet pyetja
21 nga kolegu im. Megjithatë, në qoftë se do të shikojmë mënyrën
22 se si është formuluar pyetja, në faqen q37, rreshti 2, 3 dhe
23 4, dhe pyetja është:

24 "Për të qenë, pra, nuk ka ndodhur në të njëjtën ditë.
25 Pra, nuk ka ndodhur me 23 dhe 24 mars incidenti me familjen

1 tuaj, apo jo”.

2 Kjo është një pyetje e cila sugjeron përgjigjen. Mbase
3 mund të ketë një tjetër mënyrë që t’i bëhet një pyetje me fund
4 të hapur dëshmitarit dhe në qoftë se është ky rasti, atëherë
5 mund të vazhdojmë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë
7 sugjerimi keni juve? Ju kuptoj plotësisht.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sugjerimi është që në qoftë se
9 kolegu dëshiron të marri një përgjigje për këtë pyetje, duhet
10 ta formulojë ndryshe pyetjen. Pra duhet të bëjë një pyetje me
11 fund të hapur.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Avokat, ju lutem vetëm kjo pyetje, sepse kjo temë është cekur
14 mjaftueshëm.

15 Të lutem, vendosni edhe njëherë dëgjueset, z. Dëshmitar.
16 Faleminderit.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]
18 Py. Z. Dëshmitar, më herët sot, juve ju përgjigjët një
19 pyetjeje që bëra unë. Unë të pyeta: “Kur kanë ndodhur sulmet
20 ajrore në vitin 1999?”.

21 Përgjigjen juve e keni dhënë në faqen 18, rreshti 24, dhe
22 thatë:

23 “Në vitin 1999, nëse nuk gaboj, sulmet ajrore kanë
24 filluar me datë 23 dhe 24 mars, të vitit 1999”.

25 Pyetja ime është kjo: Ne folëm rreth një incidenti që i

1 ka ndodhur familjes tuaj. Unë dua që të sigurohem në qoftë se
2 [në] këto ditë konkrete, pra me 23 apo me 24 mars 1999, ka
3 ndodhur incidenti në familjen tuaj?

4 Py. Incidenti ka ndodhur në familjen teme mbas -- si ta them,
5 mbasi NATO-ja ka filluar bombardimet. Tani ka ardhur polici e
6 janë hyrë nëpër lagje dhe incidenti ka ndodhur te familja jeme
7 mbas bombardimeve të NATO-s.

8 Py. Kur ndodhi ky incidenti, incidenti që na përshkruat,
9 incidentin në të cilin ishte përfshirë edhe djali juaj 4
10 vjeçar. Çfarë i bënë konkretisht djalit tuaj?

11 Py. Djalit tim në atë kohë s'i kanë bërë asgjë, por kam parë
12 duke rrahur nënën e djalit, bashkëshorten time, duke e rrahur,
13 dhe prej asaj kohe djali është me -- qysh me të thënë -- me
14 kësi lloj trauma, i ka. Kam pas nëpër mjekë, nëpër asoj -- por
15 e ka pasur. I ka mbetur ajo frika e trauma, djalit në krye. Në
16 tru, i ka -- si me të thënë -- bashkëshorten time e kanë
17 rrahur.

18 Pë. Në rregull. Cila ishte arsyeja që ata erdhën në shtëpinë
19 tuaj. A e dini ju këtë gjë?

20 Pë. Arsyeja ime, nuk muj ta cekim personalisht, por kanë hyrë
21 nëpër krejt lagjen, nëpër shtëpia. Pastaj kanë hyrë nëpër
22 lagjen, dhe kanë -- i kanë nxanë nëpër shtëpia ata dhe i kanë
23 maltrajtuar. I kanë maltrajtuar dhe i kanë rrahur. Se s'kanë
24 hyrë vetëm tek unë, por kanë hyrë edhe nëpër shtëpi të tjera.

25 Py. E kuptoj. Kur kishte ndodhur ky incident, a morët ndonjë

1 mbështetje nga njerëzit?

2 Pë. Po, ndërkohë, ndërkohë mbas incidentit, ka pasur edhe
3 popullatë -- të tjera, anash në atë lagje, tona aty. Kanë
4 ardhur pjesëtarë të ushtrisë tonë, Ushtria Çlirimtare e
5 Kosovës, tre persona. Kanë ndenjur në mbrëmje, kanë ardhur e
6 kanë ndenjur gjatë ditës. Na kanë dhanë kurajë, kurajë në atë
7 aspektin, mbështetje morale, mos me u tutë, mos me u frikësu.
8 S'kanë punë me juve, kanë punë me neve. Kësisoj gjërash. Na
9 kanë dhënë mbështetje të moralshme.

10 Py. E kuptoj. Kush ishin këta njerëz nga UÇK-ja që erdhën te
11 ju?

12 Pë. Po, ka qenë Fatmir Humolli, Salih Mustafa dhe një tjetër
13 ka qenë, por për Zotin, atij emrin s'mund, t'ja harroj -- ja
14 kam harruar. S'mund ta mbaj mend. A këta të -- po.

15 Kanë qenë në lagjen tonë, kanë biseduar personalisht me
16 mua, se e kanë e ditur që unë punoj në Kryqin e Kuq, më kanë -
17 - kështu -- kanë biseduar me mua: si po shkon puna. Ja kam
18 sqaruar pakë a shumë punën e popullatës, stresin e popullatës.

19 Py. Ku shkove ti me ta?

20 Pë. [E pakuptueshme] për atë natë, në mbrëmje, kur kanë
21 ardhur, kanë bujtur te shtëpia e axhës tim. Kanë bujtur, kanë
22 qëndruar gjithë natën. Të nesërmen tërë ditën kemi biseduar me
23 popullatën nëpër asaj, me popullatë. Edhe unë kam qenë bashkë
24 me ta. I kemi vizituar popullatën, kemi bisedu me popullatën,
25 Salihi u ka dhënë mbështetje morale, se "mos u tutni, s'keni

1 për çka me u frikësu, s'jeni kështu -- s'kanë punë me juve.
2 Kanë punë me ne, apo që hyni edhe NATO-ja, kështu që s'kemi" -
3 [e pa kuptueshme] mbështetje të moralshme që për mos me u
4 frikësu më tepër. Deri në mbrëmje kanë qëndruar.
5 Py. Në rregull. Afërsisht, pas sa kohe kur ndodhi incidenti
6 me bashkëshorten dhe djalin tuaj erdhën ata? Nëse të kujtohet,
7 nëse mund ta thuash.

8 Pë. Atë për zotin s'më kujtohet saktësisht. Por ka qenë data,
9 në mos gabofsha, fundi i marsit, fillimi i prillit. Tash s'më
10 kujtohet a ka qenë data 30 apo 2, 3, 4 prill, s'më kujtohet.
11 Q'atë periudhë kanë qenë në lagjen tonë. Prej datës 30 deri me
12 datë 2, 3, 4, s'më kujtohet saktësisht cilat ditë. S'jam i
13 sigurt cilat ditë kanë qenë. Ama e di që ka qenë fundi i
14 marsit dhe fillimi i prillit. Q'ato ditë kanë qenë.

15 Py. A e njihnit burrin e tretë?

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
17 pyetje ka marrë përgjigje. Tha që "Nuk e di". Nuk e njihte.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. A e kishit parë këtë personin e tretë më përpara?

20 Pë. Jo.

21 Py. A ju kujtohet se çfarë kishin veshur Fatmiri dhe Salih
22 Mustafa?

23 Pë. Janë kanë në do xhaketa të thjeshta, kështu janë kanë.
24 S'kanë pasur kështu ndonjë diçka. Të thjeshta janë kanë. Pa
25 armatim janë kanë dhe me një torbë në dorë janë kanë. Fletore

1 i kam parë që i kanë pasur, fletore në dorë, laps. Thjesht
2 janë konë kështu, por e dinim që janë të UÇK-së në atë kohë.
3 Py. Për çfarë ishin të interesuar ata?

4 Pë. Këta kanë qenë të interesuar veç me marrë informacione
5 nga popullata se qysh po zhvillohet puna, ato -- apo të kemi
6 maltrajtime apo kemi probleme, apo na maltrajton kush. Ne i
7 kemi sqaruar që këto, këto, këto sende i kemi pasur. Probleme,
8 edhe u kemi shpjeguar krejt çka është pyetja -- por domethënë
9 në lagjen tonë, aty.

10 Py. Në kohën kur keni folur me ta, a kishin armë me vete ata?

11 Pë. Armë, kur kemi biseduar ne me ata, apet që kanë ardhur,
12 edhe kanë shkuar, ne armë në këta persona nuk i kemi parë. I
13 kemi parë vetëm me një torbë, një torbë - çantë, e kanë pasur
14 kështu, në dorë me vete. Ama çfarë ka pasur në atë çantë, unë
15 nuk e di se s'i kemi pa sendet në çantë. Armë me vete në trup,
16 ose në krah, kështu, s'kanë pasur.

17 Py. Ti personalisht a i ke shoqëruar ata ndërkohë që ata
18 flisnin me persona të tjerë? Apo -- a mund në na e shpjegosh
19 pak se si ka ndodhur kjo?

20 Pë. Gjatë kohës kur kanë ardhur, kanë bujt te shtëpia e
21 axhës. Të nesërmen nëpër lagje kemi biseduar me popullatën.
22 Unë jam kanë në prezencë me ta, i kam bërë bisedë me
23 popullatën. Kam biseduar normalisht, normal kështu, secili
24 duke i treguar hallet e veta. Këta i kanë, siç duket Fatmiri,
25 në mos gabohem, i ka shënuar në një fletore. I ka shënuar

1 hallet e popullatës, çfarë problemi kanë pasur ose çfarë ka,
2 qysh, lypshin ndihmë prej tyre, kam orientu tash pej, kështu -
3 -

4 Py. Ju thatë që ju thanë fjalë inkurajimi. Po personave të
5 tjerë me të cilët u takuan, çfarë ju thoshin ata?

6 Pë. Po, qysh me kanë thënë edhe mua, q'ashtu ju thoshin edhe
7 personave të tjerë. I lypshin ndihmë pej tyne. Kah do të
8 shkojmë, kah do të - kështu. Ja tregonin kështu çdo familjari,
9 ja kanë treguar hallin Fatmirit dhe Calit. Ja kanë treguar
10 hallin që "Ne kemi këto punë, kemi kësoj". Por megjithëse këta
11 dy personat gjithë ditën janë kanë në mbështetje të popullit
12 dhe duke ju thënë fjalë të mira, jo fjalë të këqija, kështu,
13 dhe duke ju thënë fjalë që "mos u tutni. S'keni çka me u tutë.
14 S'kanë punë me juve. Na kemi punë me ta, ata kanë punë me neve
15 e ju s'keni çka me u brengosur". Kështu, secila familje tuj i
16 qa hallet e veta, tuj i pyet për qysh me u lehtësu, qysh --
17 ajo lagje aty.

18 Py. Ku shkuan ata eventualisht? E kuptoj që ata kanë qëndruar
19 në shtëpinë e axhës tuaj. Po ku shkuan pastaj, eventualisht?

20 Pë. Në shtëpi të axhës, kam thënë prapë, kanë fjetur atë
21 natë. Të nesërmen në mëngjes jemi takuar prapë aty te unë dhe
22 kemi dalë nëpër lagje. Kanë biseduar tanë ditën me popullatën,
23 u kanë thënë fjalë të urta, të mira popullatës. Në mbrëmje,
24 kanë kërkuar për me dalë, edhe --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Avokat, mendoj që dëshmitari nuk e ka kuptuar pyetjen tuaj
2 sepse po përsëriste atë çfarë po thoshte. Nuk ka kuptuar kohën
3 kur ka ndodhur. Mbase mund të jesh pak më i qartë në pyetjen
4 për të.

5 Juve thatë "Kur shkuan ata eventualisht".

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
8 jepet në faqen 44, rreshti 3 dhe duhet që të specifikoni, të
9 thoni konkretisht se kur e keni fjalën kur thoni
10 "eventualisht"?

11 Z. VON BONE: [Përkthim]

12 Py. A ju thanë ata juve se ku do të shkonin kur u larguan
13 prej aty, kur u ndanë prej teje?

14 Pë. Kanë kërkuar që t'i dërgoj deri te rruga që i dërgon për
15 pjesën e Llapit. Atëherë i kam shoqëruar, unë i kam shoqëruar
16 e i kam treguar rrugën prej lagjes tonë, kanë me u nis për
17 rrugën që i çon për zonën e Llapit. Edhe ata kanë shkuar. Në
18 mbrëmje kanë shkuar, nuk e di - mbrëmje e di që ka qenë -
19 09.00, 10.00 e mbrëmjes, 11.00 bën vaki. Nuk e di. S'jam i
20 sigurt saktë. Thjesht kanë shkuar në drejtim të zonës së
21 Llapit.

22 Py. Në rregull. A mund të na thuash se në çfarë drejtimi
23 ishte zona e Llapit. Ishte në drejtim të veriut, të lindjes,
24 të perëndimit, jugut? Në qoftë se do të marrim Prishtinën si
25 pikë referimi, mund të na e sqarosh pak ju lutem?

1 Pë. S'po di edhe unë, mund të mundohem. Kjo ka, e thash edhe
2 më herët e kam problem me kohën. Është, në mos gabofsha, në
3 drejtim të veriut, në mos gabofsha. S'po di.

4 Py. A kishin ndonjë mjet transporti ata?

5 Pë. Jo, mjet transporti s'kanë pasur. Në këmbë janë kanë.
6 Janë ardhur, në këmbë kanë shku.

7 Py. Kjo ka qenë e vetmja periudhë kohe kur jeni takuar me
8 Salih Mustafën?

9 Pë. Me Salih Mustafën jam takuar edhe dy herë apo tre herë më
10 herët, te Kryqi i Kuq. Te zyrat e Kryqit të Kuq, në rrugën që
11 të çon për Gërmi. Më herët, para bombardimeve.

12 Py. Për të qenë të qartë, fitet për sulmet e NATO-s me datë
13 23 dje 24 mars. E saktë është kjo?

14 Pë. Po. Jo, "më herët", po mendoj para sulmeve të NATO-s, a
15 prej sulmeve të NATO-s, në atë kohë e kam parë. Në datën -- në
16 fund të marsit, në fillim të prillit. Ajo datë ka qenë. Kanë
17 qenë afër 24 orë te ne dhe kanë vazhduar tani për Podujevë,
18 për zonën e Llapit.

19 Py. Kur e keni parë atë më përpara, më herët, për çfarë erdhi
20 ai në zyrën tuaj?

21 Pë. Është fjala për Salihin?

22 Py. Po, për Salih Mustafën.

23 Pë. Po, më herët ka qenë në zyrat tona -- vinin si popullata
24 tjetër. Ka qenë edhe Salih, kanë marrë pajisje të nevojshme
25 medicinale, ka marrë gjëra të tjera. Veshmbathje e kësi sende,

1 ushqim dhe i kanë marrë në zyrat tona dhe i kanë transferuar
2 për zonat e tyre mandejna. Është fjala për më herët.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Avokat.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 rreshtin -- më lejoni që ta gjej - pra ka ndryshuar pak
8 transkriptimi. Kur jemi te rreshti 46, -- faqja 46, rreshti 6,
9 domethënë, ishte Salihi, ndërkohë që ishte shkruar Cali më
10 përpara. Domethënë u bë korrigjimi në transkriptim kështu që
11 nuk është më e vlefshme pyetja që doja t'ju bëja.

12 Z. VON BONE: [Përkthim]

13 Py. A e keni takuar atë edhe pas lufte?

14 Pë. E kam takuar një herë në rrugë. Jemi takuar rastësisht në
15 rrugë dhe më ka pyetur: "Si je, Kryqi i Kuq?" Thashë: "Mirë,
16 faleminderit. Ju si jeni?". Kaq.

17 Edhe jemi takuar në KFOR, në kazermën ushtarake. Kemi
18 pasur Kryqi i Kuq, forcat e sigurisë së Kosovës dhe KFOR-i
19 kemi pasur një ushtrim fushor, i cili u mbajt në pikën
20 doganore të Vërnicsës, në kufi. [E pakuptueshme] kemi pasur
21 edhe në kazermë. [E pakuptueshme] Adem Jashari, jemi takuar në
22 oborr, kështu dhe më ka përshëndetur: "Si je?". "Mirë,
23 faleminderit. Ju si jeni?". "Mirë" dhe kaq.

24 Py. A e dini çfarë bënte ai në UÇK?

25 Pë. Për kë është fjala, çfarë bënte?

1 Py. Për Salih Musfafen?

2 Pë. Për Salih Mustafen, çfarë ka bërë në UÇK nuk më kanë
3 ngjarje, veç e di që si ushtar, kështu. Po çka ka bërë, nuk e
4 -- nuk jam ngjarje. S'kam dëgjuar kurrëgjë.

5 Py. Po Fatmir Humolli a e dini çfarë bënte në UÇK?

6 Pë. As për Fatmir Humollin nuk jam në dijeni çka ka bërë dhe
7 çfarë roli ka pasur.

8 Py. Kur erdhi te ju dhe qëndroi një natë në shtëpinë e axhës,
9 e kuptova që mbanin shënime. Po me këtë informacion që ata
10 mbledhnin çfarë bënin? A ju thanë? A keni dijeni për këtë?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

12 Avokat, kam një pyetje për ju, por mund t'i hiqni dëgjueset,
13 z. Dëshmitar.

14 Z. Avokat, mund edhe t'i kthehem transkriptimit, por mua
15 m'u duk sikur ai tha që shënimet janë mbajtur një ditë më pas
16 kur kanë shkuar që të vizitojnë, të takojnë disa njerëz në
17 lagje. Nuk ka qenë në mbrëmjen kur kanë qëndruar në shtëpinë e
18 axhës.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund ta them ndryshe pyetjen. por
20 thjesht janë mbajtur shënime, kjo ka rëndësi dhe çfarë kanë
21 bërë me këtë informacion është pyetja.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë e
23 kuptoj shumë mirë.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Nëse kjo pastaj, se kur ka
25 ndodhur - ditën e parë a ditën e dytë, për mua kjo -- nuk më

1 intereson edhe aq momenti kohor, por më shumë informacioni,
2 pra nëse e kanë marrë në ditën e parë, a ditën e dytë, e çfarë
3 kanë bërë me atë informacion.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Avokat, unë ju kuptova shumë mirë se cili ishte qëllimi i
6 pyetjes suaj, por nëse ja bëni pyetjen dëshmitarit duke i
7 thënë sikur ka thënë diçka, por faktikisht nuk e ka thënë
8 ashtu, unë këtë e kam problem. Do t'ju lutesha që ta
9 perifrazonit, ta thoshit ndryshe më saktë, mundësisht duke
10 dhënë edhe referimin, por ta bëni pyetjen siç duhet.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta bëj edhe një herë pyetjen.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Dëshmitari i ka vendosur prapë dëgjueset. Në rregull, mund të
14 vazhdoni.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta bëj një pyetje me hapa
16 atëherë.

17 Py. Kur Salihu dhe Fatmiri dhe ai i treti erdhën te ju, ju na
18 thatë se ata dëgjonin se çfarë kishin njerëzit për të thënë,
19 edhe ju, dhe mbajtën shënime. Fatmir Humolli mbajti shënime. A
20 ju thanë pse po i mbanin këto shënime? Çfarë do bënin me këtë
21 informacion që e morën prej jush por edhe prej të tjerëve me
22 të cilët folën?

23 Pë. Jo, s'na kanë thënë se për çfarë arsye po i shënojnë.

24 Vetëm çka flisnim ne, çka ju interesonte, e shënonin pyetjet,
25 përgjigjet, kush ka folur i kanë shënuar, i kanë marrë i kanë

1 shënuar. Fatmiri i ka shënuar shënimet, e për çfarë arsyeje i
2 kanë marrë shënimet, nuk na kanë treguar.

3 Py. A dinit nëse Fatmir Humolli kishte ndonjë farë pozite,
4 roli të veçantë në UÇK?

5 Pë. Nuk e kam ditur as deri në momentin dashtë kur kam parë,
6 po mandej mbas çlirimit, se nuk e kam ditur se çfarë funksioni
7 ka pasur as Fatmiri e as Cali. Çfarë pozite kanë pasur nuk e
8 kam ditur.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua që të konsultohem, e nderuar
10 Gjykatëse, me kolegët.

11 [Avokatët e Mbrojtjes këshillohen]

12 Z. VON BONE: [Përkthim]

13 Py. Në atë kohën pas incidentit, pra periudhën kohore pas
14 incidentit që i ndodhi familjes tuaj, pra duke filluar -- aty
15 gjatë kësaj periudhe, sa kohë vazhduat ju të punonit për
16 Kryqin e Kuq kosovar?

17 Pë. Ne kemi punuar gjatë luftës non-stop dhe tash punoj prapë
18 në Kryqin e Kuq.

19 Py. Fillimisht Kryqi i Kuq i Kosovës nuk punonte në formë
20 legale, por në formë ilegale, thatë. Kur ndodhi që Kryqi i Kuq
21 i Kosovës u zyrtarizua nga institucioni i Kryqit të Kuq
22 Ndërkombëtar?

23 Pë. Po. Kryqi i Kuq mbas çlirimit të Kosovës i ka bërë --
24 zyrat kryesore tash është në qendër të Prishtinës, po i ka
25 edhe 26 degë të tjera ku përfshihen në tërë Kosovën. Kryqi i

1 Kuq ka punuar në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar deri
2 në -- edhe tash është një përfaqësues i Kryqit të Kuq të
3 Gjenevës në Prishtinë, por ne kemi punuar -- ne jemi kanë si
4 staf i Kryqit të Kuq, jemi kanë nën mbikëqyrjen e Kryqit të
5 Kuq të Gjenevës deri në vitin 2010, jemi kanë nën mbikëqyrjen
6 e Kryqit të Kuq të Gjenevës. Na kanë vëzhgu, na kanë këshillu,
7 si me ba, si me vepru. Si me kanë të paanshëm dhe në vitin
8 2010 atëherë e kemi marrë atë, qysh me thanë unë, atë njohjen
9 pej Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe tash jemi të pavarur.

10 Py. E kuptoj. Ndonjë prej të Kryqit të Kuq të Kosovës, ndonjë
11 punonjës i Kryqit të Kuq të Kosovës me të cilin ju punonit
12 atëherë ka vdekur gjatë luftës?

13 Pë. Po vetëm doktori, Shpëtim Robaj, ka vdekur. Dhe kanë
14 vdekur tani mbas, personat të tjerë, por vullnetarët tanë kanë
15 vdekur mbas luftës dhe një ka shkuar në Francë, [e
16 pakuptueshme], tjetra në Suedi a s'di ku ka shkuar.

17 Py. Kryqi i Kuq a kishte zyrë në Llukar?

18 Pë. Jo.

19 Më fal, a mundem?

20 Kryqi i Kuq, se të thashë ose --- me vullnetarët e vet në
21 vitin 2000 e -- 2000 në mos gabofsha, i kam harruar edhe ato
22 vite. Vullnetarët e Kryqit të Kuq, ndër ta jam kanë edhe unë
23 vetë. Në varrezat e dëshmorëve, në varrezat ku janë ata, e
24 kemi bërë rivarrimin e shtatë personave. Aty ka qenë prezent
25 KFOR-i, ka qenë prezent UNMMIK-u në atë kohë dhe ka qenë

1 prezentë Zyra Ligjore. Ne i kemi bërë zhvarrimin, i kemi hapur
2 gropat, personat e OSBE-së i kanë marrë dhe i kanë futur në --
3 se ka pasur edhe familjarë ata, t'afërt dhe të cilët viktimat
4 janë verifikuar. Ata janë ndarë anash, të cilat nuk janë
5 verifikuar. I kanë marrë viktimat, i kanë futur nëpër thasë
6 dhe i kanë çuar në Rahovec ku ka qenë kjo Zyra Ligjore e ADN-
7 së e personave që kanë marrë pej ata te varrezave deri sa t'u
8 bëhej ADN-ja e tyre, me u verifiku ku është ajo, i kujt i
9 përket ai trup. Ato kemi bërë, zhvarrosur. Tani i kemi
10 varrosur prapë. Aty ka qenë KFOR-i, ka qenë Policia e UNMIK-
11 ut, aty ka qenë edhe -- kanë pasur ardhur edhe Cali me do
12 ushtarë, po, vetëm me xhaketa, me logo të UÇK-së. Pa armatime
13 kanë qenë ata. Janë përshëndetur me neve të gjithë, domethënë
14 si të KFOR-it, si të OSBE-së, si ata edhe këta na kanë
15 përshëndetur dhe në atë rast e kam parë Calin.
16 Py. Po çfarë kishte ndodhur në Llukar ku u rivarrosën këto
17 kufoma, çfarë kishte ndodhur në fakt?
18 Pë. Në Llukar ka ndodhur vrasja pej kolonave. Kanë marrë
19 familjarët, i kanë nxjerrë pej kolonave -- se këtu [e
20 pakuptueshme] e kanë pasur një pikë në Llukar dhe i kanë vrarë
21 familjarët edhe i kanë varrosur viktimat. I kanë varrosur në
22 një vend. Në atë vend kemi shkuar unë dhe Bija edhe Vjollca,
23 Zadja, dhe i kemi hapur në -- ato, dhe i kemi nxjerrë kufomat.
24 Cilat janë identifikuar janë varros. Cilat nuk janë
25 identifikuar, i kanë marrë e kanë çuar në morg për t'u bërë

1 ADN-në. OSBE-ja e ka pas marrë në atë kohë.

2 Py. Ju kuptova.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

4 Avokat, a mund të sqaroni për hirin tonë se si lidhet kjo me
5 provat që dëshirojë të paraqesë Mbrojtja?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Sapo e kuptova këtë. Kjo ka të
7 bëjë - mbase duhet t'i heqë dëgjueset dëshmitari?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Dëshmitar, ju lutemi hiqini dëgjueset.

10 Mund të vazhdoni, z. Avokat.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, siç e kam

12 thënë edhe në deklaratën time hyrëse, ka pasur shumë njerëz të
13 zhvendosur brenda vendit dhe një prej rrugëve ishte edhe kjo,
14 pra e këtyre personave, pra, të cilët ishin shpërngulur.

15 Rrugët kanë ndjekur disa drejtime, mes tyre edhe Llukari, që
16 është ngjitur me Prishtinën. Dhe gjatë këtyre periudhave
17 kohore, njerëzit nuk kanë qenë të sigurt, të mbrojtur. I

18 merrnin, i nxirrnin nga kolona dhe i vrisnin, pa ndonjë rend

19 të caktuar. Kjo na jep edhe një indicie të shpërnguljes të

20 njerëzve që kanë ndodhur pas sulmeve ajrore të NATO-s ku shumë
21 njerëz janë larguar, në veçanti edhe ndër të tjera në

22 drejtimin e zonës së Gollakut.

23 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

25 lidhur me aktakuzën?

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Lidhja me aktakuzën nuk përmban,
2 faktikisht, në veçanti ndonjë aspekt që është në aktakuzë. I
3 jep një karakterizim të numrit të personave që po lëviznin
4 asokohe dhe mes këtyre njerëzve, shumë prej këtyre, janë
5 larguar në drejtim të zonës së Gollakut ose janë shpërngulur
6 në drejtim të zonës së Gollakut. Kështu që mendoj se
7 dëshmitari po fliste në zonën e Gollakut për personat e
8 shpërngulur brenda vendit, dhe mes këtyre njerëzve, kishte
9 njerëz që ndiqnin rrugë të caktuara, itinerare të caktuara.
10 Sofali, Llukar, ky drejtim. E gjithë kjo është në lindje të
11 Prishtinës, pra Llukari.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Kështu qoftë por ju e kuptuat pyetjen time, por duhet të mbani
14 parasysh që të ketë edhe lidhje.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Do të përpiqem që ta mbyll, e
16 nderuara Gjykatëse, në një kuptim që të jetë me lidhje.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Para
18 se të vazhdojmë, para se të vendosi dëgjueset dëshmitari. Për
19 procesverbalin, z. Avokat, dua të vërej se në përmbledhjen e
20 dytë që bëtë sa i takon mbajtjes së shënimeve për të cilën
21 sapo diskutuam, thatë dëshmitarit në përmbledhje se:

22 "...Kuptova prej jush se ata jua dëgjuan historitë dhe
23 mbajtën shënime..."

24 Thjesht për procesverbalin, në faqen 43, në rreshtin 10
25 dhe 16, dëshmitari tha:

1 "Biseduam me njerëzit. Të gjithë thanë se çfarë
2 problemesh kishin. Nëse nuk e kam gabim, Fatmiri mbante
3 shënime në bllokun e vet, fletoren e vet. Ai mbante shënime
4 për ato me të cilat përballej popullata".

5 Thjeshtë për procesverbalin e them këtë. Mund të
6 vazhdoni. Dëshmitari po i vendos dëgjueset tani. Në rregull.

7 Z. Avokat, mund të vazhdoni.

8 Z. VON BONE: [Përkthim]

9 Py. Po, z. Dëshmitar, sapo na thatë se në Llukar kishte
10 vrasje të njerëzve të cilët i merrnin nga kolonat. Faqja 51,
11 rreshti 1 dhe 2.

12 Këto kolona, në ç'drejtim po shkonin? Jo më falni, ta bëj
13 pyetjen: së pari, çfarë kolonash ishin? Kolona të përbëra nga
14 çfarë?

15 Pë. Kolona të përbërë nga popullsia shqiptare, të cilët i
16 kanë dëbu pej fshatrave, tuj i pru për qytet, dhe pej qyteti
17 tani me i vazhdu me i qit nëpër autobusë, trena dhe me i
18 shpërngul pej Kosovës.

19 Py. Thatë se kjo ka ndodhur në Llukar, pra vrasja e njerëzve
20 që i merrnin nga kolonat. Nga kush e morët vesh që ka ndodhur
21 kjo këtu? Nga kush e dëgjuat?

22 Pë. Për këtë rast e kemi dëgjuar mbas -- mbasi që u bë
23 çlirimi i Kosovës. E kemi dëgjuar që kanë vrarë atë popullsi
24 dhe i kanë bërë varrezat. Dhe në bashkëpunim ne si vullnetarë,
25 si të Kryqit të Kuq, kemi shkuar me punëtorë -- ato -- dhe

1 kemi tërhequr ata trupa pej varrezave dhe kanë bërë --
2 domethënë mbas luftës e kemi marrë vesh për q'atë -- çka ka
3 ndodhur aty.

4 Pë. Thoni "pas luftës". Në ç'periudhë kohore e keni fjalën
5 kur thoni "pas lufte", në ç'moment?

6 Pë. Po kjo ka ndodhur në vitin 2000, si duket. U bë ri
7 varrimi te ne. A 1999 -- fund i vitit 1999, a viti 2000, sa
8 është. Aty diku. Q'aty më duket u bë kjo -- kjo.

9 Py. Dikush nga -- ndonjë nga familja juaaj a ka qenë në UÇK?

10 Pë. Pej familjes time asnjë s'ka qenë.

11 Py. Ndonjë prej komshinjve tuaj a ka qenë në UÇK?

12 Pë. Po, pej lagjes tonë kanë shkuar. Katër, pesë. Nuk jam i
13 sigurt, po kanë shkuar. E di për katër, pesë persona që i
14 njoh, kanë shkuar. Vullnetarë kanë shkuar, i janë
15 bashkëngjitur radhës së UÇK-së.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Avokat, a mund të t'i kërkonti dëshmitarit se çfarë e ka fjalën
18 "nga lagjja"?

19 Z. VON BONE: [Përkthim]

20 Py. A mund të thoni për komshi, komshi të cilët janë
21 anëtarësuar në UÇK, për çfarë e keni fjalën?

22 Pë. Komshi, komshi. Komshinjtë tanë janë djemtë të rinj, i
23 janë bashkëngjitur në radhët e UÇK-së. Katër apo pesë, q'ata,
24 për sa i njoh unë në atë moment. Në ato -- gjatë luftës.

25 Py. Dhe këta njerëz, banonin afër me shtëpinë tuaj apo ?

1 Pë. Rruga -- rrugën e kemi, domethënë, rruga kryesore e
2 lagjes tonë. Aty është rrugica, është e gjatë dhe janë disa më
3 të larta, disa më poshtë me shtëpi, kështu. Po personalisht
4 prej familjes tonë, aty s'ka qenë.

5 Py. Këta u kyçën në UÇK vullnetarisht, apo ju bë thirrje që
6 bashkohen në UÇK? Dini?

7 Pë. Këta kanë -- vullnetarisht u kanë kyç dhe thirrjes kur u
8 bë -- përgjithësisht u bë thirrje. Qysh me të thënë unë më
9 parë, u përhap në të gjitha aspektet, në të gjithë Kosovën që
10 kush do, kush mundet e ka mundësi, me ju bashkëngjitur
11 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në atë kohë. Për me i ndihmue,
12 me i dhanë një ndihmë popullit, ushtarëve, me ju ba ballë
13 armikut.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Avokat, i përdorët dy orë.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Kam përfunduar, e nderuar
17 Gjykatëse. Një moment të konsultohem.

18 [Avokatët e Mbrojtjes këshillohen]

19 Z. VON BONE: [Përkthim]

20 Py. Pyetja e fundit që kam është kjo: pas lufte, a jeni
21 anëtarësuar ju vetë në ndonjë shoqatë të veteranëve të luftës?

22 Pë. Jo.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, nuk kam
24 pyetje të tjera.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit, z. Avokati i Mbrojtjes.

2 Në rregull. Z. Prokuror, është thujse 12:30. Dëshironi
3 të vazhdoni tani me kundrapyetjet apo dëshmitarët të veprojë
4 siç vepruam javën që shkoi, që të bëjmë një herë pushimin
5 tani, pushimin e drekës, dhe pastaj të pyes një NJAGJ-në që
6 atë gjysmë ore që s'e përdorim tani ta përdorim më pas. E keni
7 ju në dorë.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sugjeroj
9 që të vazhdojmë mbas pushimit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 mirë.

12 Z. Ademi, do të bëjmë tani një pauzë prej një ore e
13 gjysmë për të ngrënë drekën, pas së cilës, domethënë në orën
14 14:00, do të rikthehemi këtu dhe pastaj e ka rendin Zyra e
15 Prokurorit të Specializuar që t'ju bëj pyetje. E keni të
16 qartë?

17 DËSHMITARI: Në rregull, pajtohem.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Atëherë, z. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni
20 dëshmitarin të dalë nga salla. Do të shihemi bashkë më vonë.

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
24 mirë. Do të rifillojmë në orën 14:00.

25 Këtu bëhet ndërprerja e seancës.

1 --- Pauza e drekës fillon në orën 12:27

2 --- Seanca rifillon në orën 14.00

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Përpara se të sjellim Dëshmitarin në sallë, dua që të shikoj
5 se kush është i pranishëm dhe dua të jap një urdhër me gojë.

6 Shikoj se përbërja është e njëjtë kështu që le ta
7 shënojmë këtë për procesverbal.

8 Do të jap një urdhër gojor që ka të bëj me materialet të
9 cilat janë nxjerr kohët e fundit nga ZPS-ja. Trupi Gjykses
10 vëren se ZPS-ja ka kërkuar leje nga Trupi Gjykses për
11 përdorimin e materialeve në burim të hapur me Dëshmitarin 400
12 për marrjen në pyetje prej ZPS-ës të dëshmitarit, përmes
13 emailit të dërguar në orën 9.42.

14 Trupi Gjykses ka shqyrtuar kërkesën e ZPS-së dhe ka
15 shqyrtuar gjithashtu dhe arsyen se, pse nuk është nxjerr më
16 përpara ky material.

17 Trupi Gjykses konstaton se, ZPS-ja ka shkaqe të arsyeshme
18 që nuk i ka bërë të ditur këto materiale më përpara.

19 ZPS-ja e lejoi që të përdor këto burime gjatë marrjes në
20 pyetje të Dëshmitarit 400 dhe vendos më tej se Mbrojta, në
21 qoftë se dëshiron, do të ketë kohë shtesë në mënyrë që të mund
22 të studiojë materialet edhe që të përgatisë parashtrimet e
23 veta lidhur me të.

24 Ky është fundi i urdhrit gojor.

25 Znj. Sekretare, ju lutem a mund ta sillni dëshmitarin në

1 sallë?

2 Ndërkohë, mund të them se çfarë është planifikuar mbas
3 sesionit. Do të jemi këtu nga ora 14.00 deri në 15.30, do të
4 kemi 15 minuta pushim dhe pastaj do të kemi 30 minuta sërish
5 deri në orën 4.30, do të vazhdojmë me procesin sot.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 se erdhe, z. Ademi.

9 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
11 do të vazhdojmë me marrjen në pyetje nga ZPA-ja, nga
12 Prokuroria. për t'ju thënë lidhur me orarin që do të qëndrojmë
13 në Gjykate tani, do të jemi këtu nga tani deri në orën 15.30,
14 pastaj do të bëjmë 15 minuta pushim dhe do të kemi plus 30
15 minuta deri në përfundim të seancës së sotme. E kuptuat? Në
16 rregull?

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit.

20 Z. Prokuror, fjala për ju.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Shumë faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës.

23 Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk:

24 [Përkthim]

25 Py. Z. Ademi, mirëdita.

1 Pë. Përshëndetje. Mirëdita.

2 Py. Si jeni pas pushimit?

3 Pë. Mirë, Mirë. Nuk është keq, mirë është.

4 Py. Z. Ademi, unë jam Avokati për Prokurorinë. Jam Prokurori
5 që do t'ju marr në pyetje nga ana e Prokurorisë. Përderisa
6 kemi kohë të kufizuar, do ju kërkoja që të më dëgjoni me
7 kujdes, për pyetjet që do t'ju drejtoj dhe dua që të më jepni
8 përgjigje lidhur me pyetjet. Në qoftë se nuk do të më jepni
9 përgjigje në lidhje me pyetjet, atëherë do t'ju ndalojmë dhe
10 do t'ju kërkojmë që të jepni përgjigje vetëm lidhur me
11 pyetjet. Kjo ka të bëjë me shkuarjen në një linjë, le të
12 themi, të pyetjeve dhe të përgjigjeve.

13 A më kuptoni?

14 Pë. Po.

15 Py. Z. Ademi, ju sot thatë që nga Kryqi i Kuq kosovar gjatë
16 luftës, pra në Kryqin e Kuq të Kosovës punonin vetëm 6 vetë
17 prej jush. Dhe kjo është dhënë në faqen 15, rreshti 18 deri 20
18 të transkriptit. A është e saktë kjo?

19 Pë. 6 vetë apo 7 vetë kemi punuar.

20 Py. A njihni ndonjë person tjetër me emrin Ahmet Ademi që ka
21 punuar në Kosovë për Kryqin e Kuq gjatë kohës së luftës?

22 Pë. Po. Ai person jam unë, që kam punuar në Kryqin e Kuq edhe
23 punoj përsëri.

24 Py. Meqenëse po flasim për Kryqin e Kuq të Kosovës që ka
25 funksionuar nga fundi i luftës deri më sot, a njihni ndonjë

1 person tjetër me emrin Ahmet Ademi që ka punuar për Kryqin e
2 Kuq të Kosovës që ka punuar gjatë kësaj kohe?

3 Pë. Ju thashë që unë jam Ahmet Ademi që kam punuar dhe punoj
4 përsëri. Ahmet Ademi, unë jam.

5 Py. Pyetje ime është kjo, a njihni ndonjë person tjetër,
6 përveç teje, që quhet Ahmet Ademi dhe ka punuar për Kryqin e
7 Kuq të Kosovës?

8 Pë. Më fal. Po, ka pasur. Është Hafiz Veseli, ka punuar. Ai
9 përsëri punon. I ndjери Muharrem...

10 Py. Ju kërkoj ndjesë zotëri. Pyetja ime nuk është se kush
11 ishin personat e tjerë që punonin në Kryqin e Kuq të Kosovës.

12 Pyetja ime është kjo: Gjatë luftës, a ka pasur ndonjë person
13 tjetër përveç teje që kishte emrin Ahmet Ademi dhe punonte për
14 Kryqin e Kuq të Kosovës? Ishe vetëm ti me këtë emër, apo
15 kishte person tjetër që kishte po të njëjtin emër?

16 Pë. Jo, i vetmi unë kam qenë me këtë emër. Persona të tjerë
17 me këtë emër s'ka pas, për sa e kuptova.

18 Py. Po, kjo ishte pyetja ime. E njëjta pyetje ka të bëjë me
19 kohën nga fundi i luftës deri më sot. A njeh ti ndonjë person
20 tjetër, përveç vetes, që e ka emrin Ahmet Ademi, që ka punuar
21 për Kryqin e Kuq të Kosovës? Apo je vetëm ti, nuk ka person
22 tjetër me këtë emër që njeh?

23 Pë. Emër tjetër unë nuk njoh përveç emrit tim, që ka punuar
24 edhe punon.

25 Py. A njeh ti ndonjë person tjetër në Kosovë që ka të njëjtin

1 emër dhe të njëjtin mbiemër që ke ti, pra që quhet njësoj si
2 ti, Ahmet Ademi?

3 Pë. Jo, nuk njoh.

4 Py. Z. Ademi, si e ka emrin babai juaj?

5 Pë. Sherif.

6 Py. Fillimi i emrit të babës tuaj është "sh" apo jo?

7 Pë. "Sh", S-h. S-h.

8 Py. E kuptoj. Z. Ademi, në dëshminë që dhatë sot, dhe e kam
9 fjalën konkretisht për faqen 54, rreshti 9, ju thatë që askush
10 nga anëtarët e familjes tuaj nuk ka qenë anëtar i UÇK-ës. A
11 është e saktë kjo?

12 Pë. Po. Po, e saktë është. Nga familja ime, personalisht, nga
13 familja ime e ngushtë, asnjë person nuk ka qenë.

14 Py. Ti vetë, a ke qenë pjesëtar i UÇK-ës, i Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës gjatë luftës?

16 Pë. Unë vetë s'kam qenë ushtar, por ju kam shërbyer me barna,
17 me gjëra ushqimore popullatës. Dhe ato kanë qenë edhe ushtria,
18 në ato zona ku kam qenë unë edhe ua kam dërguar gjërat
19 ushqimore, veshmbathje, shtroje, mbulesa, pelenat, qumësht për
20 bebe edhe medikamente.

21 Py. Z. Ademi, e kuptoj përgjigjen e pyetjes. Por pyetja ime
22 ishte pak sa ndryshe. Pyetja ime është kjo: Ti vetë, a ke qenë
23 pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Është një pyetje që
24 kërkon një përgjigje të thjeshtë, po ose jo.

25 Pë. Jo.

1 Py. A e kuptoj drejt, gjë që rrjedh nga përgjigja që sapo na
2 thatë, që ju nuk keni qenë anëtar i ndonjë brigade të Ushtrisë
3 Çlirimtare të Kosovës ose të ndonjë njësiti ushtarak të
4 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E saktë është kjo?

5 Pë. Kjo e saktë që s'kam qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të
6 Kosovës.

7 Py. Pavarësisht kësaj, ju i keni kryer detyrat, funksionet
8 tuaja në Kryqin e Kuq të Kosovës sipas urdhrave apo vendimeve
9 që janë dhënë nga komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
10 gjatë luftës?

11 Pë. Ne si Kryq i Kuq i Kosovës, prej kurrkujt s'kemi marrë
12 urdhra, as na ka komanduar askush me na dhënë urdhër me thonë
13 me e krye këtë punë. Por vetë i kemi dalë ndihmë, i kemi marrë
14 pyet popullatën se çka ju nevojitet, çka, se. E kemi
15 grumbulluar atë material edhe e kemi mbartur me çanta, me
16 duar, me krah, me krejt i kemi mbartë dhe i kemi çuar nëpër
17 ato zona ku i ka lyp popullata. Edhe i kemi dorëzuar në fshat,
18 ose qytet, ose ku ka pas nevojë.

19 Py. Sot na thatë në faqen 15 rreshtat, nga 12 deri në 15, që
20 ishte një Fond që quhet Vendlindja Thërret. A është e saktë
21 kjo?

22 Pë. Po.

23 Py. Po ashtu na keni thënë, në të njëjtën rresht, që aty afër
24 gjendej një farmaci. Nga farmacia njerëzit merrnin barna. Me
25 sa e kuptova, kjo farmacia ishte e lidhur me Fondin Vendlindja

1 Thërret. A ishte kështu, a ishte e lidhur farmacia me Fondin
2 Vendlindja Thërret?

3 Pë. Po, e ka pas një marrëveshje barnatorja. Kanë qenë afër
4 ato. Kanë pas marrëveshje me Vendlindja Thërret që, çka të
5 nevojitet që të vijnë person i Kryqit të Kuq ose dikush, me
6 çfarë të nevojitet me i dhanë barna pa kurrfarë problemi. Na
7 kanë dhanë barna, i kemi marrë barnat nga barnatorja dhe i
8 kemi distribuua.

9 Py. Ne e dimë që ky Fondi Vendlindja Thërret ishte i lidhur
10 ngushtë me UÇK-në. Pyetja ime është kjo: Kjo barnatorja për të
11 cilën ne po flasim, a menaxhohej, a drejtohej nga Ushtria
12 Çlirimtare e Kosovës?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Përpara se t'i përgjigjeni z. Ademi, a mund t'i hiqni pak
15 dëgjueset ju lutem?

16 Z. Prokuror, mbase nuk e kam kapur, kështu që të lutem më
17 korrigjo në qoftë se e kam gabim, por kjo lidhja ndërmjet
18 Fondit Vendlindja Thërret dhe UÇK, a e kemi diskutuar sot këtë
19 çështje?

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'jua gjej referencën në
21 transkript për një çast, por u përmend Fondi Vendlindja
22 Thërret dhe në të njëjtin paragraf, me sa e kuptoj unë, pati
23 dhe diskutime lidhur me këtë barnatoren nga e cila njerëzit
24 merrnin furnizimet, merrnin materialet.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pra, më doli natyrshëm që kjo
3 ishte lidhja.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Pyetja është në qoftë se kishte një lidhje ndërmjet Fondit
6 Vendlindja Thërret edhe UÇK-ës, sepse këtë po nënkuptoni apo
7 jo?

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, absolutisht kështu është.
9 Sepse nuk është se ishte e qartë për neve se si ishte lidhja,
10 nga e dinte. Kishte ndonjë informacion historik që kishte
11 lidhje ndërmjet Fondit Vendlindja Thërret dhe UÇK-ës?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
13 kisha preferuar që ta kishit prezantuar ndryshe çështjen për
14 atë kohë sa nuk ishte diskutuar.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull, e nderuar
16 Gjykatëse. Do ta bëj ndryshe pyetjen.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
20 Py. Atëherë, do t'jua bëj ndryshe pyetjen z. Ademi. Kjo
21 barnatorja që juve sapo e cekët, a drejtohej nga Ushtria
22 Çlirimtare e Kosovës?

23 Pë. Po më vjen shumë keq, por unë nuk kam njohuri a është
24 drejtuar nga UÇK-ja. Ne kemi pasur vetëm me shku me i marrë
25 barnat, çka na u ka nevojit dhe i çuam në distribuim.

1 Py. Kush ishte personi në atë kohë, gjatë luftës, kush ishte
2 personi i cili e menaxhonte barnatoren, kush e drejtonte atë.

3 Nuk e di, ia dini emrin, ndonjë nofkë që ka përdor ky personi?

4 Pë. Nofka nuk di. E di që ka qenë një i shtabit, ato

5 Vendlindja Thërret, ka qenë Garra mbiemrin. Garra mbiemrin.

6 Emrin për momentin emri s'po më bien në mend, por mbiemrin

7 Garra.

8 Py. Z. Ademi nuk ka problem. Ky personi, Garra, a ishte

9 pjesëtar i UÇK-ës, me aq sa dini ju?

10 Pë. Kurrë në jetë s'e kam pa me uniformë pjesëtar të UÇK-ës.

11 Sa herë kemi pas kontakt me të tek barnatorja, kurrë jetë s'e

12 kam pa me uniformë, as kështu. Nuk e di a ka qenë pjesëtar, a

13 s'ka qenë. S'jam i sigurt.

14 Py. Z. Ademi, në deklaratën e sotme, dhe i referohem këtu

15 faqes 17, rreshtat nga 12 deri në 14, ju thatë që:

16 "Kishte persona të caktuar të cilët vinin për të marrë
17 materialet nga ne". Dhe citoj atë çfarë thatë juve: "Dhe më
18 tej i shpërndanin këto furnizime, këto materiale në fshatra,
19 në qytete".

20 A është e saktë kjo?

21 Pë. Ka pas do persona të cilët i kam parë, kanë ardhur kohë

22 pas kohe. Ka pasur një herë, dy herë, tre herë i kam pa edhe

23 kanë marrë materiale edhe kanë çuar. Ndër ta është edhe Hafiz

24 Veseli, ai ka qenë personi i caktuar i cili me i marr barnat,

25 veshmbathje, shtroje mbuloj, ushqim për bebe, pelena. Edhe i

1 ndjeri Muharrem Makolli, edhe ai ka qenë i kyçur, i ndjeri ka
2 ndërruar jetë para pak muajsh. Edhe unë jam ai që ka mbart
3 barna, kam mbart sende çfarë iu kanë nevojat popullatës, i
4 kemi dërguar nëpër popullatë, nëpër vende.

5 Py. Hafiz Veseli, ky personi i parë që përmendët, a ishte
6 pjesëtar i UÇK?

7 Pë. Jo, s'ka qenë kurrë, as nuk është.

8 Py. Muharrem Makolli?

9 Pë. Muharrem Makolli, i ndjeri, unë e di që ai s'ka qenë
10 pjesëtar i UÇK-ës.

11 Py. Në dëshminë e dhënë sot ju thatë që, si anëtar të Kryqit
12 të Kuq ju shkonit në rajone të caktuara. Më konkretisht juve
13 përmendët zonën e Drenicës, Llapit, Karadakut, Gjilanit edhe
14 këtu mund t'i referohemi deklaratës që dhatë sot në faqen 15,
15 në rreshtat 22 deri në 24.

16 A është e saktë që ti ke shkuar në këto zona?

17 Pë. Po, e saktë është. Kam shkuar nëpër këto zonat të cilat i
18 kam përmend sot.

19 Py. Duke folur për zonën e Drenicës, ku shkonit ju
20 konkretisht, në cilin vend konkretisht shkonit atje?

21 Pë. Unë kam shkuar në Shalë, thirrret fshati Shalë, ish
22 Sedllare, komuna e Drenovcit, e Gllogovcit.

23 Py. Çfarë kishte në atë fshatin që quhej Shalë, ish
24 Sedallare? Çfarë kishte atje?

25 Pë. Ato kanë pasur popullatë, ka qenë një spital privat në të

1 cilën janë mjekuar popullata, ushtria. Janë mjekuar në atë
2 fshat, në atë spital.

3 Py. Kush e drejtonte atë spital në fshatin Shalë?

4 Pë. Po më vjen shumë keq, por emrin nuk e di. Ka pasur mjekë
5 të ndryshëm, por emrat nuk i di.

6 Py. Ai spital, a drejtohej apo menaxhohej nga UÇK-ja gjatë
7 luftës?

8 Pë. Nuk jam në dijeni. S'mund me dhanë përgjigje për, a e ka
9 menaxhuar UÇK-ja apo mjek, nuk e di kush e ka menaxhuar.

10 Py. Sa herë keni shkuar atje gjatë luftës? Sa herë keni
11 shkuar në atë spital gjatë luftës?

12 Pë. Në spital kam qenë një herë. Në fshat kam qenë 2 herë apo
13 3 herë. Edhe ma s'kam shku andej.

14 Py. Le të flasim për zonën e Llapit, zona e dytë që ju
15 përmendët në dëshminë tuaj. Ku shkonit, në çfarë vendi konkret
16 shkonit, kur shkonit në zonën e Llapit?

17 Pë. Unë personalisht kam shkuar deri në fshatin Lupç, është
18 Lupç dhe në mes Majac thirret ai fshati. Lupç, Majac edhe ato
19 kanë pas popullatë të zhvendosur.

20 Py. A kishte ndonjë godinë mjekësore në Lupç dhe në Majac, që
21 keni shkuar juve?

22 Pë. Jo, s'kam pa as spital ushtarak, as spital kështu, s'kam
23 pa. Përveç që kam pa, ndërtesa ka qenë e Nenës Terezë, që iu
24 bëheshin ndihmat, u shpërndaheshin ndihmat prej aty. Ka qenë
25 si një objekt i vogël, si shtëpi e vogël. Dhe prej aty behej

- 1 shpërndarja e ndihmave, prej asaj zyrës së Nenës Terezë.
- 2 Py. Duke folur për zonën e Llapit gjatë luftës, ti vetë ke
3 shkuar në Llapashticë?
- 4 Pë. Në Llapashticë nuk kam qenë.
- 5 Py. Po të flasim rreth zonës së Gollakut, a mund të thoni
6 vendin ose vendet ku keni qenë gjatë luftës për të çuar
7 materialet?
- 8 Pë. Po. Në zonën e Gollakut kam qenë tek fshati Bresalc.
9 Ashtu më duket quhet, mos gabofsha, Bresalc. Nga Novobërdë
10 andej, Bresalc quhet. Deri aty kam arritur, kam çuar sende.
- 11 Py. Çfarë kishte aty në atë fshat?
- 12 Pë. Në atë fshat ka qenë pothuajse i boshatisur. Në ato ku i
13 kemi çuar ne ndihmat, ka qenë pothuajse i boshatisur. Ka pas
14 popullatë, por ka pas jo sikur në këto regjionet e tjera. Më
15 pak ka pasur popullatë në atë fshat.
- 16 Py. A ka pasur ndonjë ndërtesë tjetër, si për shembull ndonjë
17 spital ku ju i çonit materialet atje?
- 18 Pë. Jo. Mua, s'kam has në ta me pa, s'kam pa.
- 19 Py. Po në Karadak, në çfarë vendi ose në çfarë vendesh i keni
20 dërguar ju materialet, sendet tuaja?
- 21 Pë. Karadak i bien tash, Gollak edhe Karadak janë afër. Afër
22 janë, s'po mund me ta caktu. Se ne i themi edhe Karadak, edhe
23 Gollak. Gollaku është këndeje nga ana e Gjilanit, Karadaku
24 është këndeje nga ana -- e rrok me Prishtinë dhe Podujevë, e
25 rrok një farë pjese, aty thirret fshati Gllogovicë.

1 Py. Ky është fshati tek i cili ju keni dërguar materialet
2 tuaja gjatë luftës, pra në zonën e Karadakut? Këtë po thoni?

3 Pë. Po. Është kjo, fshati Gllogovicë thirret. Por është më
4 poshtë se fshati Gllogovicë, në mund ta quaj si lagje, si pa
5 hy në fshat, është një para-lagje. Aty i kemi dorëzuar dhe
6 jemi kthyer përsëri.

7 Py. Po Gjilani. Ku shkonit në Gjilan për të dërguar
8 materialet tuaja?

9 Pë. Në Gjilan kemi shkuar i kemi dërguar në zyrën e Nenës
10 Terezë, në Gjilan afër parkut, ku është sot parku në Gjilan.
11 Afër parkut ka qenë një objekt i Nënë Terezës, aty i kemi
12 dorëzuar edhe jemi kthyer përsëri.

13 Py. Z. Ademi, a e njihni një njësi të Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës që quhet BIA?

15 Pë. BIA, jo. Jo, s'e di.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen
17 tuaj dëshiroj t'i shfaqim dëshminë e dëshmitarit për
18 Mbrojtjen, ku ai e përmend shprehimisht këtë njësi. Edhe do të
19 doja t'i bëja pyetje lidhur me të.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
21 lutem, vazhdoni z. Prokuror.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëshmia e Mbrojtjes mban datën
23 25 maj 20201, me numrin DSM00452-00459, faqe 6.

24 Py. Në transkriptin e deklaratës që keni dhënë për Mbrojtjen,
25 është një pyetje që thotë:

1 "A e mbani mend se kush jua ka thënë këtë gjë"?

2 Dhe përgjigja jua është që:

3 "Njerëzit vinin nga të gjitha zonat në Kryqin e Kuq. për
4 shembull vinin nga Gjilani dhe kur vinin ata thonin BIA. Dhe
5 kështu që i pyeta të më thonin se çfarë nënkuptonte BIA dhe
6 ata më thonin që, ata ishin ushtarë të Kosovës".

7 Pyetja është kjo: A ia keni thënë këtë gjë Mbrojtjes. Z.
8 Ademi?

9 Pë. Ekziston mundësia që ia kam thënë, por për momentin nuk
10 mua kujtua. Ekziston mundësia që ia kam thënë, por

11 personalisht unë nuk e kam dit se çka domethënë fjala BIA.

12 Py. Por, të paktën a e dinit se çfarë ishte brenda Ushtrisë
13 Çlirimtare të Kosovës ?

14 Pë. Si çfarë ishte? Çfarë.

15 Py. Çfarë ishte? Nuk e kam fjalën për shkurtimin BIA se çfarë
16 kuptimi ka, por çfarë ju kujtohet juve se çfarë ishte BIA në
17 UÇK?

18 Pë. Unë për vete nuk e kam ditur. Thoshin BIA, BIA, është
19 BIA. Tash a ka qenë ndonjë njësi e veçantë, apo s'ka qenë
20 njësi e veçantë BIA, unë nuk e di. Por këtë e kam dëgjuar edhe
21 prej popullatës kur vinin ato tek zyrat e tona me marr
22 materiale, me marr sende, e kam dëgjuar që BIA, BIA, BIA. Por
23 e kam pyet çka është, me kanë thënë që është e ushtrisë. Tash
24 çfarë ushtrisë, nuk e di, BIA. A ka qenë BIA fjala për
25 ushtarët e UÇK-ës? Unë tek popullata aty e kam dëgjuar në, po

1 mendoj tek zyrat e Kryqit të Kuq, BIA.

2 Py. A ju kujtohen emrat e atyre personave të cilët ju vinin
3 në zyrën e Kryqit të Kuq edhe ju thoshin se ishin të BIA-s?

4 Pë. Ato kur -- unë për vete s'kam qenë në dijeni se s'i kam
5 njohur askënd, por i kam dëgjuar tek zyra që thoshin, erdhën
6 pjesëtar, këta të BIA-s edhe me marrë sende. Ndër ta ka qenë
7 komandanti, ky komandanti -- ndër ta ka qenë Salihi, atëherë e
8 quanin Cal. As unë emrin s'ia kam dit, e quanin Cali, Cali. I
9 merrte sendet me do persona të tjerë, i merrnin sendet gjërat
10 ushqimore, medikamente për mjekësi e kësi sendi, i mbushnin
11 torbat dhe vazhdonin rrugës. Ai ka qenë 2 herë apo 3 herë tek
12 ne në atë kohë. E aty e kam dëgjuar fjala BIA, BIA. Çka
13 domethënë, se unë as kam qenë në ngjarje, as s'e di çka
14 domethënë. Edhe sot nuk e di çka domethënë fjala BIA.

15 Py. Z. Ademi, juve e dini nëse Cali ishte anëtar i BIA-s ,
16 vetë ai?

17 Pë. Jo, s'e kam dit kurrë.

18 Py. A njihni ndonjë anëtar të njësitit BIA?

19 Pë. Jo, s'kam njoft. As e kam dit në atë kohë. Bile as kam
20 njoh cilët janë pjesëtarët e BIA-s, apo të këndejna të
21 ndryshëm. S'e kam dit.

22 Py. Sot na thatë se erdhën dy anëtarë të UÇK-ës në Prishtinë
23 dhe qëndruan në shtëpinë e axhës, është në transkriptin e
24 sotëm në faqen 43, rreshti 10.

25 Pyetja që kam unë është kjo: Si jua quajnë axhën? Ku

1 qëndruan këta tre anëtarët e UÇK-ës?

2 Pë. Shtëpia e axhës thirret, i ndjeri ka ndërruar jetë,
3 Sulejman Ademi.

4 Py. Ai vetë, ishte anëtar i UÇK-ës?

5 Pë. Jo, se ai ka qenë plak shtatëdhjetë e -- afër 80 vjeç.
6 Dhe ka qenë Haxhi.

7 Py. Z. Ademi, sot na thatë se pas lufte nuk iu bashkuat
8 "ndonjë shoqate të veteranëve të luftës" dhe po citoj këtu.
9 Kështu?

10 Pë. Po. Pas luftës unë gjithmonë e kam dash humanizmin dhe
11 jam human dhe as nuk kam dash me iu bashku asnjë shoqate
12 veteranëve apo tjetërkujt, përveç Kryqit të Kuq. Që punoj në
13 Kryqin e Kuq.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Referenca është në faqen 55,
15 rreshtat 13 deri në 15, të nderuar Gjykatës.

16 Py. Z. Dëshmitar, pavarësisht nga ajo që po thoni ju, a keni
17 dijeni nëse ju vetë jeni në të vërtetë në listën e veteranëve
18 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

19 Pë. Unë në listën e veteranëve të Kosovës jam i regjistruar,
20 por pjesë në luftë s'kam marrë. Më kanë regjistruar që kam
21 dhënë kontributin tim, mundin tim e kam dhënë kontributin për
22 aq sa kemi punuar ne. Dhe më kanë ba veteran të -- po du me
23 thanë, si të logjistikës që kam dhënë kontributin tim gjatë
24 luftës nëpër tërë këto vende të cilat i përmenda. Edhe jam në
25 listën e veteranëve, por asgjë nuk përfitoj.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Prokuror?

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
5 t'ju kërkoj juve dhe dëshmitarin që të bëni një pauzë pasi të
6 përfundojë secili pyetjen dhe përgjigjen. Jo kaq shpejt.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Patjetër, e nderuar Gjykatëse.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Dëshmitar, kur t'i përgjigjeni pyetjes së Prokurorit, duhet që
10 të prisni një moment. Se pastaj kjo i jep mundësi përkthyesve
11 që të bëjnë punën siç duhet, në mënyrë që të kenë kohë të
12 përfundojnë njëherë së përkthyeri atë që thoni ju.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

14 Py. Z. Ademi, sapo na treguan se: "Ata ju regjistruan në atë
15 listë për shkak të kontributit tuaj". Kush ju ka regjistruar
16 në listën e veteranëve të UÇK-ës?

17 Pë. Në listën e veteranëve të UÇK-ës, më kanë, sipas dijenisë
18 time, më kanë regjistruar pjesa e Drenicës, për kontributin
19 tim të cilën e kam ba në Drenicë.

20 Py. Emrin e personit apo personave që të regjistruan si
21 veteran të UÇK-ës, e dini si është, si e ka emrin?

22 Pë. Emri e atij personi është Nehat, mbiemrin s'e di. Nehat,
23 po. E quanin Mjekra, pseudonimin Mjekra. Ai e ka marr e ka
24 mbushur aplikacionin edhe e ka dorëzuar për arsye që kam dhënë
25 kontributin tim gjatë luftës në atë zonë.

1 Py. Çfarë pozita ka mbajtur ky Nehati në UÇK?

2 Pë. Sipas dëgjimeve mbas përfundimit të luftës, ky ka qenë
3 komandant i një toge 12-15 ushtarë në atë pikë.

4 Py. Për luftën e kisha fjalën, a e di se çfarë pozite ka pas
5 në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, gjatë luftës?

6 Pë. Gjatë luftës nuk e di çfarë pozite ka pas Nehati, por e
7 kam parë në uniformë kur i kemi dorëzuar çuar sendet andej, e
8 kemi pa në uniformë. Çfarë pozite ka pas? Nuk më ka
9 interesuar, por më ka interesuar vetëm qysh me dorëzu mallin,
10 me lënë mallin edhe me u kthy sa më shpejt me ardh në qytetin
11 tim, në Prishtinë.

12 Py. Ku e ke parë Nehatin, Mjegrën me uniformë?

13 Pë. Nehatin e kam pa në Shalë. Fshati Sedllar ka qenë më
14 herët, tani e bënë fshati Shalë, Komuna e Drenocit.

15 Py. Tek ai spitali që e cekët më përpara?

16 Pë. Në afërsi të spitalit, ka qenë. Në atë fshat por jo tek
17 spitali, po afër spitalit ka qenë diku disa metra më larg.

18 Py. Dhe kur e takuat Nehatin, Mjegrën në afërsi të këtij
19 spitali? Kur ka ndodhur që e takuat?

20 Pë. Ka ndodhur kjo, kur e kam pas Nehatin, ka ndodhur në
21 herën e dytë apo të tretë. Nuk jam i sigurt a herën e dytë, a
22 herën e tretë e kam pa atë edhe në fshatin Poklel.

23 Py. Jo. E kam fjalën për kohën, në çfarë kohe, kur ka ndodh
24 që e keni takuar Nehat Mjegrën gjatë luftës? Gjatë luftës, kur
25 jeni takuar? Kur?

1 Pë. Në vitin '98.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do t'i
3 lutesha Sekretarit që të nxirrte në ekran dokumentin me numër
4 ERN105296 deri në 105317.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
6 mund të vazhdoni.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në anën tjetër të ekranit, nëse
8 është e mundur, do t'ju lutesha që të nxirrni një dokument
9 tjetër që është përkthimi i faqes së parë me numër 105296 deri
10 në 105296-ET.

11 Të nderuar Gjykatës, ky është dokumenti të cilin e kemi
12 shkarkuar nga një institucion zyrtar, nga Qeveria e Kosovës,
13 nga faqja zyrtare në internet të Qeverisë së Kosovës, ku kemi
14 emrat e ish-ushtarëve të UÇK-ës nga zona operative e Llapit,
15 më konkretisht që kanë qenë anëtarë të Brigadës 153 dhe me një
16 tabelë ku jepen emrat dhe statusi i veteranit të personave të
17 kësaj liste.

18 Do ju lutesha që të shkojmë në fund të faqes 2 dhe të
19 fokusohemi tek numri rendor 50.

20 Py. Z. Dëshmitar, në numrin rendor 50 shohim emrin Ahmet
21 Ademi. Në mes shikojmë shkronjën Sh.

22 Pë. Po.

23 Py. Ky emri është emri juaj, jeni ju këtu?

24 Pë. Po zotëri, po.

25 Py. Para pak minutash ju bëra një pyetje shumë konkrete dhe

1 pyetja ishte: A ishit anëtar i UÇK-ës dhe ju thatë jo. Dhe pak
2 pas kësaj ju pyeta a keni qenë anëtar i ndonjë brigade apo i
3 ndonjë njësie tjetër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe
4 për këtë u përgjigjët, jo.

5 Tani, përpara kemi listën e veteranëve të Kosovës ku
6 gjegjësisht aty thuhet se keni qenë anëtar i Brigadës 151.

7 A mund t'i thoni Gjykatësve nëse keni qenë apo nuk keni
8 qenë anëtar i asaj brigade gjatë luftës?

9 Pë. Unë në shërbim të UÇK-s, anëtar i UÇK-s, nuk kam qenë.
10 Kam qenë vetëm punëtor ndihmës që i kam mbart sendet dhe i kam
11 çuar nëpër pika të ndryshme, si në Drenicë, si në Llap, si në
12 Gollak, si në Karadak, si në Gjilan, kam mbartur sende. Por
13 për hir të atyre, se s'jam i vetmi unë që jam në listë, por ka
14 dhe shumë të tjerë që janë futur në listë, të cilët njerëz e
15 kanë dhënë kontributin e vet. Nuk është e thënë vetëm me kap
16 armën edhe me dalë me luftu. Është e thënë kush ka dhënë
17 kontribut. Edhe këta mbasi e kanë ba, këta Nehati edhe këta të
18 tjerët, mbasi e kanë ba më kanë treguar që, "Të kemi shti në
19 listën e veteranëve të luftës, për kontributin e juaj të cilën
20 e ke dhënë gjatë periudhës '98-'99".

21 Py. Z. Ademi, ju vetë a dorëzuat ndonjë dokument me qëllim që
22 të bëheshit anëtar i kësaj shoqate të veteranëve, në mënyrë që
23 t'ju përfshihej emri në këtë listë?

24 Pë. Vetëm formularin e kam pasur dhe formulari ka qenë diku i
25 viteve të fundit, kur e lypshin këto [e pakuptueshme] Nehati,

1 kanë qenë edhe 2-3 të tjerë, nuk i njoh ata nuk ia di emrat.

2 Edhe më kane thënë, "Po ta plotësojmë dokumentin që e ke dhënë
3 kontributin tënd dhe po i çojmë për veteran". Kjo ka qenë
4 arsyeja krejt.

5 Py. Po ju nuk ishit anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
6 pse u pajtuar që t'ju përfshihej emri në këtë listë, në listën
7 e atyre që kanë qenë anëtar i UÇK-ës, kur ju vetë nuk keni
8 qenë?

9 Pë. Jo, në atë kohë s'kam qenë. Po veç kam qenë që kam mbart
10 sende. E kanë çuar atje, ata e kanë pas për një far lloj
11 stimulini, a ça po di unë, me ma ba këtë nder edhe me më ba
12 veteran të vendit. Se, as kam qenë nëpër luftëra. Nëpër
13 luftëra kam qenë, ama me armë e me uniforma e kësaj, jo s'kam
14 qenë unë. Veç kanë desh me më respektu për hir të punës, për
15 hir të veprës time të cilën e kam ba, edhe më kanë lajmëruar
16 ata mua. Ça po di unë kjo shoqata edhe e kanë ba veteran.

17 Py. Kur ka ndodhur që Nehati dhe këta të tjerët që nuk i
18 njihni, ju janë drejtuar, të kanë kontaktuar. E kam fjalën që
19 të kanë kontaktuar me qëllim që të ta fusin emrin në këtë
20 listë. Kur ka ndodhur kjo?

21 Pë. Kjo ka ndodh para si me thënë, para 4-5 vitesh, 6 vite.
22 Këtu diku. 7 vite mundet me qenë. Nuk jam i sigurt sa vjet.

23 Py. Zotëri, mbase e keni thënë, por unë pyetjen po e bej
24 gjithsesi.

25 Ndonjë përfitim a merrni, a kërkoni, keni të drejtë të

1 merrni për shkak të faktit që jeni në listën e veteranëve të
2 UÇK-ës, në listën e anëtarëve të ish-Brigadës 151?

3 Pë. Unë përfitime s'marr, pse jam duke punuar dhe e kam
4 rrogën time të cilën e marr me Kryqin e Kuq. Dhe përfitime
5 prej shtetit nuk marr. Njëherë ka ndodh, i kanë qitur 170
6 euro, i qitën në pagë dhe kam shkuar e i kam treguar këtij
7 Nehatit. E kam thirr e i kam treguar, i kam thënë, "Mua më
8 kanë dalë 170 euros. Do t'i kisha lut hiqi ato se s'kam nevojë
9 se jam duke punuar vetë, e kam rrogën time, djersën time e
10 s'kam nevojë me marrë 170 euro prej buxhetit të Kosovës".

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
12 nderuar Gjykatës, mund ta heqim këtë dokument nga ekrani.

13 Py. Z. Ademi, e njihni një person me emrin Brahim Mehmetaj?
14 Ndryshe i njohur me emrin Bimi?

15 Pë. Kurrë në jetë s'e kam njohur, deri tash e kam pa në
16 sallën e juaj, po në këtë vend këtu ku jam ulur unë e kam pa
17 këtë Bimin, Brahim Mehmetaj. Dhe as në Kosovë, as në Prishtinë
18 nuk e kam takuar kurrë në jetë.

19 Py. Që të jem shumë i qartë për këtë që sapo thatë, mos po
20 thoni që herën e parë që e keni parë Brahim Mehmetaj, ndryshe
21 i njohur si Bimi, e keni parë këtu në këtë sallë, javën që
22 shkoi, këtë po thoni?

23 Pë. Po. Po.

24 Py. Juve, publikisht, a keni shprehur ndonjëherë vlerësim apo
25 mbështetje kundrejt të akuzuarit të kësaj çështje gjyqësore,

1 që është Salih Mustafa?

2 Pë. S'e kuptova? Më fal.

3 Py. Do të përpiqem ta thjeshtoj, ta them më thjesht.

4 Publikisht, ju vetë, a keni thënë ndonjëherë me fjalë, me
5 gojë apo me shkrim, keni shprehur mbështetje apo vlerësim për
6 Salih Mustafën?

7 Pë. Unë personalisht e mbështes Salih Mustafën. Kam thënë
8 nëse vinë e me pyesin, kam me tregu atë realitetin e cila ka
9 qenë gjatë periudhës së luftës edhe në luftë edhe mbas luftës.
10 Por, krejt Salih Mustafën me thënë tri, gjashtë herë, shtatë,
11 s'e kam pa në jetën time. As përpara se kam njoh kurrë hiç.

12 Py. Pyetja që kam është kjo: Publikisht, a e keni mbështetur
13 ndonjëherë Salih Mustafën, a keni shprehur publikisht
14 mbështetje për Salih Mustafën gojarisht apo me shkrim? Ose
15 edhe me mjete të tjera të komunikimit, mjete elektronike, si
16 fjala bie interneti, çfarëdo lloj shprehje, mbështetje
17 publike?

18 Pë. Për me gojë as me shkrim s'kam ba. Ekziston mundësia në
19 faqen e internetit kur e kam pa, e kam ba "like", kështu a e
20 din, ia kam ba. Se kështu -- që as s'e di që kam thënë
21 ndonjëherë po e mbështes, as me gojë, as me shkrim, as kështu.
22 Por në internet e kam pa dhe ia kam ba "like". Përndryshe s'ma
23 merr mendja që kam thënë unë ndonjëherë diçka kështu.

24 Py. Këtë "like" e keni bërë një herë apo më shumë se një
25 herë?

1 Pë. Ekziston mundësia edhe më shumë.

2 Py. Çfarë keni përdorur, çfarë lloj platforme në internet,
3 keni përdor, ju vetë flas, që ta publikoni këtë "like"?

4 Pë. E kam pa në internet fotografinë e Calit, shkrime ato,
5 edhe veç ia kam ba "like". Për sa e di unë, veç "like" ja kam
6 ba, se s'kam shkru as kam ba kurrgjë hiç kështu.

7 Py. Z. Ademi, jeni juve në Facebook, keni faqe në Facebook?

8 Pë. Po.

9 Py. Keni vetëm një llogari në Facebook apo më shumë se sa
10 një?

11 Pë. Për sa e di unë, dy më duket janë. Më duket janë dy.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për hir të
13 qartësisë në këtë pikë, i lutem Sekretarit të nxjerrë në ekran
14 këtë dokument me numër ERN105294 deri në 105294, një faqe
15 është.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit z. Sekretar.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 Py. Z. Ademi, a është kjo llogaria juaj në Facebook? Kjo që
20 shohim në ekran?

21 Pë. Po.

22 Py. Faleminderit.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani, të
24 nderuar Gjykatës.

25 Nëse mundet, tani në ekran të nxjerrim dokumentin me

1 numër 105295 deri në 105295. Një tjetër faqe.

2 Py. Z. Ademi, edhe kjo llogari është llogaria juaj në

3 Facebook?

4 Pë. Po.

5 Py. Z. Ademi, më datë 18 nëntor 2019, Brahim Mehmetaj, Bimi,

6 personi për të cilin sapo diskutuam shkurtimisht, ka publikuar

7 dy fotografi ku ishte ai vetë dhe Salih Mustafa.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të nxjerrim në ekran

9 dokumentin që ta shohin të nderuar Gjykatës, por edhe

10 dëshmitari.

11 Është me numër SPOE00325261. Ju lutem që këtë dokument ta

12 nxjerrim në të majtë të ekranit. Në të djathtë mund të

13 nxjerrim të njëjtin dokument por me përkthimin në anglisht. Që

14 ka dhe prapashtesën ET, emri i dokumentit.

15 Py. Z. Ademi, siç ju thashë atë datë, që e shohim edhe në

16 ekran, që është 18 nëntor, Brahim Mehmetaj ka nxjerrë këto 2

17 fotografi ku ishte vetë ai dhe Salih Mustafa në aeroportin e

18 Prishtinës. Atë ditë Salih Mustafa po fluturonte për të shkuar

19 në Hagë, në përgjigje të fletëthirrjes që i kishte ardhur nga

20 Zyra e Prokurorit të Specializuar, për këtë çështje gjyqësore

21 që jemi mbledhur këtu. Ky postim në Facebook, ju kujtohet?

22 Pë. Po, më kujtohet ky postim. Këtë Salihin e kam njoh, a

23 këtë Bimin, që po e thoni Bimim, këtë kontakt kurrë në jetën

24 time s'kam pas, veçse e kam pa fotografi. E kam pa fotografi

25 por unë e kam ba fotografinë duke respektuar Salihin, Calin.

1 Edhe mos gabofsha jam "friend" a qysh i thonë ato. A këtë me
2 Bimin, jam i bindur 1 milion për qind që s'kam pas kontakt, as
3 nuk e kam dit bile se çfarë asoje ka. Veç kur e kam pa
4 fotografinë e Calit, ia kam ba për hak të Calit, "like".
5 Py. Keni bërë ndonjë koment mbështetës tek ky postim në
6 Facebook?

7 Pë. Nuk më kujtohet, nuk di. Ndoshta po, ndoshta jo, nuk e
8 di. Për "like", ma merr mendja që po. A për komente, nuk mund
9 me thënë as po, as jo. S'mund me thënë. A për "like", po.
10 Py. Z. Ademi, siç mund ta lexoni këtë postim, unë do ta lexoj
11 për ju edhe për Gjykatësit një pjesë. Brahim Mehmetaj, Bimi,
12 ka thënë kështu mes të tjerash, tek ky postim:

13 "Gjykata që është ngritur kundër shqiptarëve që kanë
14 luftuar për çlirim, është një gjykatë e specializuar. Është
15 një turp i drejtësisë. Bëhet për të denigruar çlirimtarët.
16 Turp për ata që e kanë thirrur dhe për ata që e kanë gatuar".

17 Kur i bëni "share" këtij postimi, a pajtoheni edhe me
18 rreshtat, çfarë është shkruar në këtë postim?

19 Pë. Saktësisht me të thënë të drejtën, për disa fjalë
20 pajtohem, për disa nuk pajtohem. Se gjykata është gjykatë,
21 drejtësia është drejtësi. Duhet me ardh secili njeri me dhënë
22 atë mendimin e vet, drejtësinë e vet, me shpreh punën e vet.
23 Unë nuk e shoh këtë që është 1 milion për qind i mirë ky
24 postim. Secili duhet me ardh me dhënë deklaratën e vet,
25 përgjegjësinë e vet çka ka ba, çka ka punuar.

1 Py. A e mbështetni deklaratën e Brahim Mehmetajt, që ju e
2 keni bërë share e keni ndarë dhe ju, ku thuhet që: "Kjo është
3 një turp dhe padrejtësi që bëhet për të shpërfillur dhe
4 denigruar çlirimtarët"?

5 Pë. Me të tregu të vërtetën, veç e kam pa fotografinë e
6 Calit, se as tekstin deri tash s'e kam lexuar as atëherë. Deri
7 tash që po e lexoj, s'e kam lexuar veçse e kam ba like, se veç
8 për hatër te fotografisë se Calit. Se kështu, as tekstin s'e
9 kam lexu bile, as s'e kam këqyr se çka po shkruan, as çka po
10 thotë.

11 Py. Pyetja ime është kjo: A jeni dakord me këtë rreshtin që
12 unë sapo thashë, që ky është turp, është padrejtësi dhe është
13 denigrim dhe kjo është bërë për të denigruar çlirimtarët. A
14 jeni ju dakord me këtë, z. Ademi?

15 Pë. Unë e them përfundimisht, unë s'jam dakord. [e pa
16 kuptueshme]. Se drejtësia tregon të vërtetën, të ve në punë të
17 vet. A për kësi fjalësh gjërat që shkruhen, nuk jam dakord.
18 Sidomos në postimet publike që shkruhen këto fjalë.

19 Py. Dhe një rresht tjetër është: "Turp ata që e kanë thirrur
20 dhe ata që e kanë gatuar këtë".

21 A jeni dakord me këtë rresht?

22 Pë. Unë për ata që kanë thënë turp, por që e kanë gatuar, nuk
23 mund të pajtohem me ata njerëz. Se ligji është ligj, e ka
24 caktuar dikush, ligj është ligj dhe çdo person duhet me ardh
25 edhe me dhënë atë vendimin e vet, punën e vet. Dhe në fund

1 është përgjigje si e jep gjykata a është fajtor, apo s'është
2 fajtor. Unë nuk e shoh këtë të arsyeshme pse e ka shkruar.
3 Py. Por, pavarësisht kësaj, ju e keni publikuar këtë postim,
4 apo jo?

5 Pë. Për zotin s'jam i sigurt, nuk e di.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që ta
7 heqim këtë dokument nga ekrani dhe kërkoj të shfaqet një
8 tjetër dokument i cili lidhet me këtë postim në Facebook, që
9 është SPOE00325274. Ju lutem shfaqeni në të majtë të ekranit
10 në mënyrë që për brinjë të shfaqet edhe përkthimi në anglisht.
11 Dokumenti ka të njëjtën numër, por mbaron me ET në fund.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit Sekretare.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
15 Py. Mund të shohim që ndërmjet personave që kanë komentuar në
16 këtë postim në Facebook, është edhe një person me emrin Ahmet
17 Ademi. Më parë ju na thatë që kjo ishte faqja e juaj e
18 internetit. Dhe nën këtë person shkruhet: "Respekt Komandant
19 Calin". A e mban mend që e ke botuar, e ke publikuar këtë
20 koment?

21 Pë. Ekziston mundësi që e kam ba dhe e kam ba respekt. E kam
22 ba respekt Komandant Cali edhe çka? E kam ba thjeshtë një
23 koment. Respekt kam ndaj tij dhe s'po shoh këtu kurrgjë të
24 keqe që ka.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të

1 konsultohem pak me kolegët e mi? Faleminderit

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
3 lutem, vazhdoni.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë të nderuar
5 Gjykatës për durimin.

6 Py. Z. Ademi, përpara se sa të filloj të tregoj këtë postim
7 në Facebook, ju thatë që është e mundur që të keni bërë edhe
8 postime të tjera mbështetëse, është e saktë kjo? Pra, postime
9 që ishin mbështetëse për Salih Mustafën, për këtë e kam
10 fjalën.

11 Pë. Po. Thashë edhe më herët që është e mundur që kam ba
12 "like" po, por edhe "respekt" e paskam ba.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që
14 dëshmitarit tani t'i tregohet dokumenti që është me numër
15 reference SPOE00345284 [sipas përkthimit] dhe dua të shfaqet i
16 njëjti dokument i përkthyer në anglisht. Është i njëjti
17 dokument me të njëjtin numër referimi me ET në fund.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit Sekretare.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

21 Py. Z. Ademi, ky është mesazhi apo postimi i Brahim Mehmetaj,
22 që njihet ndryshe me emrin Bimi, që mban datën 18 dhjetor
23 2019. Ky është një ditë pasi është thirrur Brahim Mehmetaj nga
24 Zyra e Prokurorit të Specializuar. Këtu kemi të gjithë
25 postimin që ka bërë z. Mehmetaj.

1 A mbani mend të keni bërë ndonjë koment poshtë këtij

2 komentit që ka shkruar z. Mehmetaj?

3 Pë. Nuk jam i sigurt, por gjithçka mund të ndodhë. Por s'jam
4 i sigurt. Ndoshta edhe e kam ba, s'jam i sigurt. Me vetëdije
5 s'besoj, a pavetëdije -- kështu. S'jam i sigurt.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
7 shfaqim një tjetër dokument në ekran tani, SPOE0325318 dhe
8 përkthimin e këtij dokumenti në gjuhën angleze.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit z. Sekretar

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 Py. Z. Ademi, nën postimin e Bimit, Brahim Mehmetajt, ju keni
13 botuar komentin tuaj:

14 "Respekt për ju Komandant, me ju Brahim Mehmetaj, Bimi".

15 A është kështu?

16 Pë. Po.

17 Py. Pra, ti flet me komandantin, me Brahim Mehmetaj, por pak
18 minuta më parë ju na thatë që hera e parë që e keni parë Bimin
19 dhe që e kuptuat se kush ishte Bimi, ishte një javë më përpara
20 kur ai ishte i pranishëm në gjykatë kur ishte ulur
21 ekzaktësisht në vendin ku je ulur ti sot.

22 Pyetja ime është kjo: A i keni treguar të vërtetën kësaj
23 Gjykate? A nuk e keni njohur vërtetë Brahim Mehmetajn, Bimin,
24 kur keni bërë postimin komentit tuaj në dhjetor?

25 Pë. Të betohem sinqerisht nuk e kam ditur që është Komandant

1 Bimi, Brahim Mehmetaj, derisa e kam pa -- se unë s'i kam ba
2 veçse këtij koment për shembull, por i kam ba edhe të tjerëve
3 komente, i kam respektuar i kam ba komente. A nuk e kam ditur
4 që ka qenë Komandant Bimi, Brahim Mehmetaj, deri sa e kam pa
5 në këtë sallë këtu. S'e kam njoh, as kam pas kurrë bisedë me
6 të, por veç kështu prej -- e kam shënuar, respekt. Se as kurrë
7 në jetë me të me fol s'kam.

8 Py. Sapo na thatë që ju nuk e dinit që Brahim Mehmetaj ishte
9 komandant. Ndërkohë që në postimin tuaj shkruhet: "Respekt
10 komandant". Çfarë përgjigje keni për këtë?

11 Pë. Po, e kam shkruar. Se unë zakonisht çdokujt i shkruaj,
12 "respekt", ia bëj komandant. Respekt. Nuk është e thënë se
13 është për Brahimin apo për Calin, apo është për - pa marrë
14 parasysh - për Mjegrën, apo për ata, se unë e kam respektuar
15 gjithmonë uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kam
16 dhënë kontributin tim sa kam pas mundësi. E për atë zakon e
17 për respekt, e kam shkruar "respekt komandant".

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shumë
19 shkurtimisht sepse nuk kam shumë dokumente të tjera,
20 megjithatë dua që t'i tregoj dëshmitarit një tjetër dokument,
21 me numër identifikimi 105322.

22 Py. Z. Ademi, ky është ri-postim i profilit të Brahim
23 Mehmetit që mban datën 20 shkurt 2020. A e keni rishpërndarë,
24 ripostuar këtë logo, këtë embleme?

25 Pë. Po. Këtë e kam pa, për hak -- po, që e kam pa edhe e kam

1 ba "like" edhe u dalën ne shpërndarje. Po, unë e kam ba këtë.

2 Py. Çfarë janë Skifterët, e di ti këtë?

3 Pë. Për zotin Skifterët s'e di. Veç i di që janë këta që
4 fluturojnë, skifterët që i thonë që fluturojnë nëpër qiell,
5 skifterët. Se për ndryshe këto që po i shoh tash këto -- se
6 edhe vetë nganjëherë unë veç e shoh, më pëlqen diçka dhe ia
7 bëj "like" ose e postoj, a e kupton. Se s'jam i -- se kam
8 ditur. Skifterët e di që janë këta që fluturojnë, që hanë
9 pulat, gjarpërinjtë e kësi sende.

10 Py. Sot na thatë që nuk dinit gjë për BIA-n, që thjesht
11 kishit dëgjuar këtë emër. Megjithatë siç mund ta shikojmë nga
12 kjo logo, apo nga kjo fotografi, ka një gjë të shkruar aty që
13 quhet guerilja BIA. A mund ta shihni këtë?

14 Pë. Ah, po. Po, e shoh. Në atë kohë unë s'kam dëgjuar as për
15 gueriljen, as për BIA-n, as për Skifterët. S'e kam dit në atë
16 kohë. Është fjala gjatë periudhës së luftës. Nuk i kam
17 dëgjuar, as ato, as gueriljen, as Skifterët, as BIA-n. Unë
18 thjeshtë e kam dëgjuar në zyrat e Kryqit të Kuq fjalën BIA,
19 çka do me thënë BIA, BIA prej popullatës kur vinin i merrnin
20 sendet materialet që merrnin dhe shkonin. Të betohet që unë
21 s'e kam dit se çka është fjala BIA.

22 Sa për Skifterët, skifterët e di që janë shqiponja,
23 fluturojnë edhe --.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam dhe 2
25 dokumente të tjera dhe do përfundojmë me këtë pjesë.

1 A mund të shfaqim në ekran dokumentin me numër 105325.

2 Py. Z. Ademi, siç mund ta shihni, më 11 shtator 2020, ju keni
3 ri-postuar këto tre fotografi me emrin e grupit Zona Operative
4 e Llapashticës dhe nënshkrimi poshtë fotografive është
5 "Llapashticë 1998". A është e saktë kjo?

6 Pë. Po, e saktë është.

7 Py. Kush janë këta njerëzit në këto fotografi? Duke filluar
8 me këtë personin që është kështu si më i madh, në pjesën e
9 sipërme.

10 Le të fillojmë nga e majta dhe do lëvizim në drejtimin e
11 akrepave të orës, nga e majta në të djathtë.

12 Pë. Këto këtu nuk i njoh. Një fotografi më poshtë, në anën e
13 majtë, siç më vjen mua këtu, është pak ma herët që e ceka që
14 kanë shkuar prej lagjes tonë, kanë shkuar vullnetarisht
15 ushtarë. Njëri ndër ta është këtu i fotografuar, tek ky
16 automjeti këtu, tek kjo shtëpia, tek ky automjeti. Është
17 kojshiu im i afërt, që ka shkuar vullnetarisht me i shërbye
18 popullit, vendit.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund ta zmadhojmë ju lutem?
20 Shumë faleminderit.

21 DËSHMITARI: Është ky me kapuç. Kapelën e ka në kokë. Më
22 lart, në këmbë është me kapuç.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
24 tre veta që kanë kapuç.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 Py. A mund të na thoni është në të majtë, në të djathtë, në
2 mes, ku?

3 Pë. Është këndej nga -- me tesha të zeza, me kapuç. S'po di
4 qysh. Është tek Xhipi këndej. Tash mua më bie në anën e
5 djathtë, fotografia, mua më bie në anën e djathtë, këndej. Në
6 këmbë është. Kojshia im është.

7 Py. A është në këmbë përpara makinës me ngjyrë të gjelbër apo
8 makinës të bardhë?

9 Pë. Jo, si duket kjo është këndej si ngjyrë të bardhë. Goma
10 është e mbuluar me atë bezen. Në këmbë është, jo ky djali me
11 uniformë, po ky tjetri, më i gjatë është pak, me tesha të zeza
12 është edhe me kapuç.

13 Py. E kuptoj. Si quhet, si e ka emrin ky?

14 Pë. Ky e ka emrin Fadil Hajrizi. Kojshiu imi është.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund t'i heqim këto dokumentet.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
17 lutem vazhdoni me heqjen z. Sekretar.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 Py. Z. Ademi, a keni pas ndonjë kontakt ju me Salih Mustafën
20 që prej kohës kur është arrestuar nga Dhomat e Specializuara
21 të Kosovës?

22 Pë. Jo, s'kam pas.

23 Py. A keni pasur ndonjë kontakt me ndonjë anëtar të familjes
24 së tij që nga momenti kur është arrestuar z. Mustafa?

25 Pë. S'jam i sigurt, s'po më kujtohet. S'jam i sigurt. Nuk e

1 di. S'po më kujtohet.

2 Py. A njihni ndonjë anëtar të familjes së Salih Mustafës?

3 Pë. Nuk mundem me thanë, nuk mundem me dit me thënë 1 milion
4 për qind që po. S'jam i sigurt që është ai për shembull, është
5 ky a. S'jam i --.

6 Py. Z. Ademi, vërej në transkriptin e deklaratës së Mbrojtjes
7 me ju.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dhe për procesverbal është
9 transkripti i datës 25 maj 2021. Me numër reference DSM00452
10 deri në 00459.

11 Py. Shoh në faqen 7 të kësaj deklarate, që në një pikë të
12 caktuar është bërë një pushim nga intervista, a është e saktë
13 kjo?

14 Pë. Po. Në atë kohë ka qenë një pushim. Se kam pas qenë i
15 bamë operacion. Kam pas me shku më herët, kam pas me shku tek
16 mjeku me ba vizitën edhe pastrimin e varrës. Por, duke u marrë
17 në pyetje, duke u marrë në pyetje deri sa i thashë, mua më
18 duhet e kam kohën për me shku tek mjeku me ba pastrimin e
19 varrës edhe kontrollin. Edhe kam shku për një orë, e kam ba
20 pastrimin dhe jam kthyer përsëri.

21 Py. Gjatë pushimit, a diskutuat për dëshminë që po i jepnit
22 Mbrojtjes me ndonjë?

23 Pë. Prej atij momenti të cilën e kam biseduar me avokatin,
24 deri më sot, me njeri gjallë s'kam biseduar, as nuk e din kush
25 çfarë kam fol e as tek kam fol, nuk e din asnjëri. Përveç deri

1 sot tek ju këtu.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse mund
3 të më lejoni një çast për t'u konsultuar me kolegët dhe do ta
4 mbyllim së shpejti pyetjen, marrjen tonë në pyetje të
5 dëshmitarit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
7 lutem, z. Prokuror.

8 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndoshta
10 është momenti i përshtatshëm që të bëjmë një pushim të
11 shkurtër, siç është parashikuar në fillim të kësaj seance. Pas
12 pushimit do të themi se çfarë pozicioni kemi edhe në qoftë se
13 kemi pyetje të tjera. Por, maksimumi një ose dy pyetje të
14 tjera kemi.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit z. Prokuror.

17 Z. Ademi, tani do të bëjmë një pushim prej 15 minutash
18 dhe pastaj do të vazhdojmë me dëshminë tuaj.

19 Do t'i kërkoj Sekretares që t'ju shoqërojë nga salla e
20 gjyqit. Në rregull?

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit znj. Sekretare. Do të rifillojmë pas 15 minutash.

25 Këtu ndërpritet seanca.

1 --- Pauza fillon në orën 15:25

2 --- Seanca rifillon në orën 15:39

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së
4 pari të shoh palët. Po, janë përbërje të njëjta. Do të
5 vazhdojmë.

6 Znj. Sekretare, a mund ta sillni dëshmitarin në sallë?

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit znj. Sekretare.

10 Mirë se u kthyet z. Ademi.

11 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

13 Prokuror, keni fjalën.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi
15 pyetje të tjera. Kemi përfunduar kundra pyetjet.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

20 Mbrojtësja e Viktimave, keni pyetje? Ju ka ardhur rendi.

21 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju

22 faleminderit. Nuk do t'i bëjmë pyetje dëshmitarit.

23 Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Z. Avokat i Mbrojtjes, dëshironi që t'i bëni pyetje
2 plotësuese dëshmitarit?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi
4 pyetje të tjera.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit z. Avokat.

7 Z. Ademi, ju ka bërë pyetje Avokati Mbrojtës dhe z.
8 Prokuror. Kemi dhe ne si Trup Gjykues disa pyetje. Dëshiroj
9 t'ia jap fjalën Gjykatësit që është ulur në të majtën time.
10 Keni fjalën.

11 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit znj. Kryetare e
12 Trupit Gjykues.

13 Pyetje nga Trupi Gjykues:

14 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Ademi, sot në faqen 44 të
15 transkriptit në rreshtat 6 dhe 7 po flisnit për 3 anëtarët e
16 UÇK-ës të cilët erdhën pas incidentit që i kishte ndodhur
17 familjes tuaj. Dhe thatë kështu:

18 "Atë natë qëndruan në shtëpinë e axhës tim. Të nesërmen
19 në mëngjes u takuam bashkë"

20 Kështu?

21 Pë. Po, atë natë kanë ardh në mbrëmje, kanë bujtur në
22 shtëpinë e axhës. Të nesërmen në mëngjes kemi dalë nëpër
23 lagje, ka biseduar me muje me dalë nëpër lagje në popullatë
24 edhe i thojshin fjalë të urtë popullore, që i thonë fjalë të
25 buta që mos keni frikë mos keni kështu, deri në mbrëmje. Në

1 mbrëmje tani kanë vazhduar për në fshatin, një fshat është
2 afër Prishtinës që s'më kujtohet tash emri për momentin, [e
3 pakuptueshme] në drejtim të Podujevës, në drejtim të Llapit
4 kanë shku.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Në deklaratën
6 që ia keni dhënë Mbrojtjes më 25 maj të vitit 2021, me numër
7 DSM00456, keni thënë kështu:

8 "Kanë ardhur natën dhe natën e kanë kaluar në shtëpinë e
9 axhës. Unë qëndrova me ata. Qëndruam së bashku deri të
10 nesërmen deri nga ora 11 a 12 e natës".

11 Keni qëndruar gjatë natës me ata, apo u takuat të
12 nesërmen?

13 Pë. Këta në mbrëmje kanë ardhur, këta tre personat. Kanë
14 ardhur në mbrëmje, kanë biseduar me mua. Kanë shkuar tek
15 shtëpia e axhës, i kam çuar. Kanë fjet në mbrëmje ato. Të
16 nesërmen në mëngjes janë çuar, kanë biseduar me mua, kanë
17 biseduar me popullatën ato që ishin mbledhur, deri në mbrëmje
18 nga ora diku 10, 11 e natës. Dhe i kam vazhduar në rrugën që
19 çon për në Llap. I kam drejtuar në drejtim të Llapit, afër
20 fshatit -- është një fshat afër aty quhet si lagje. Nga
21 Kolovica i kam drejtuar edhe kanë shkuar për në Llap.

22 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, natën nuk qëndruat me
23 ata?

24 Pë. Këta natën kanë fjetur vetë brenda. Ne kemi qenë jashtë
25 nëpër oborr, nëpër kështu. Unë kam qëndruar për vete

1 personalisht jashtë, kam qëndruar se mos po -- si një lloj
2 sigurie të them, që mos po vjen kush edhe prej policisë serbe
3 ose ushtrisë serbe me na zënë edhe me na maltrajtuar akoma më
4 shumë. Kemi qëndruar zgjuar gjithë natën, deri të nesërmen në
5 mbrëmje kanë qëndruar këta tre persona, tek ne.

6 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Gjithë natën keni qëndruar në
7 oborr?

8 Pë. Gjithë natën. Ekziston mundësia me hy 5 minuta ose 10
9 minuta deri brenda në shtëpinë tonë, se shtëpitë me shtëpinë
10 axhës afër i kemi pasur. Ka ekzistuar mundësia që 10 minuta, 5
11 minuta kam hy brenda kam marrë një çaj ose një ujë ose diçka
12 dhe kam dalë tek qyshja e oborrit, në qysh të rrugës dhe kemi
13 shikuar rrugën që mos po vijnë kush prej policisë serbe ose të
14 ushtrisë serbe, që mos po vijnë dhe po na zënë, kështu. Këta
15 tre personat kanë fjetur në shtëpinë e axhës sime, vetë
16 brenda. Ne kemi qëndruar jashtë.

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po. Në të njëjtën deklaratë
18 me numër DSM00456, keni thënë pasi ju ka bërë pyetje Avokati i
19 Mbrojtjes, "A njihje ndonjë prej këtyre personave", edhe këtu
20 bëhet fjalë për anëtarët e UÇK-ës, ke thënë që:

21 "Njihja njërin prej këtyre sepse vinte përpara
22 bombardimeve të NATO-s. Vinte me 2 a 3 ushtarë. Mendoj se
23 ishte Salihu [sipas përkthimit] me dikë tjetër".

24 Pra, asokohe ju kujtohet që ishte Salihu [sipas
25 përkthimit]. Ishit i sigurt që ishte Salihu [sipas

1 përkthimit], apo nuk ishit i sigurt që ishte Salihu [sipas
2 përkthimit]?

3 Pë. Me thënë të vërtetën unë s'kam qenë i sigurt se s'e kam
4 njohur kurrë, kurrë nuk e kam njohur Salihun. Është fjala
5 përpara bombardimeve kur vinte. Ka qenë 2 herë apo 3 herë, me
6 2-3 vetë ka qenë dhe kanë marrë pajisje tek ne, kanë marrë
7 barna, kanë marrë të ëmbël, kanë marrë për fëmijë si gjera
8 ushqimore për fëmijë ka marrë, pelena ka marrë, veshmbathje i
9 kanë mbushur torbat edhe kanë shkuar. A ka qenë 2 herë, apo 3
10 herë, s'jam i sigurt saktësisht, tek zyrat e Kryqit të Kuq.

11 Ato i kam dëgjuar që kanë thënë Cali, Cali dhe unë për
12 vete s'e kam njohur.

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit shumë. Unë nuk
14 kam më pyetje të tjera.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Ademi, nuk ka më pyetje Trupi Gjykses, që do të thotë se kemi
20 mbërritur kështu në fund të dëshmisë suaj. Ju falënderoj z.
21 Ademi për përpjekjet që bëtë për të dhënë dëshminë këtu, e
22 cila besoj se do të na ndihmoi në punën tonë për të gjetur të
23 vërtetën dhe për të fituar më shumë sqarim nga ato që thatë ju
24 këtu sot.

25 Ju falënderojmë shumë. Ju urojmë rrugë të mbarë në

1 shtëpi. Ju rikujtoj që dëshminë tuaj këtu që keni dhënë në
2 Dhomat e Specializuara, të mos ta diskutoni me askënd. Këtu
3 përfundon dëshmia juaj.

4 DËSHMITARI: Ju përshëndes. Jini të bindur që deklaratën
5 time nuk e din askush, askush s'ka me e kuptu çka kam fol, çka
6 kam thënë. Dhe juve ju dëshiroj një punë të mbarë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Thjeshtë thashë që mos diskutoni me askënd për këtë. Por
9 sigurisht, njerëzit e kanë dëgjuar dëshminë.

10 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin
11 të dalë nga salla.

12 [Dëshmitari largohet]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit znj. Asistente e sallës.

15 Të shohim atëherë. Z. Prokuror, keni diçka për të ngritur
16 para Trupit Gjykses?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo të nderuar Gjykatës, nuk
18 kemi asgjë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Znj. Mbrojtëse e Viktimave?

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
24 mirë.

25 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni diçka të cilën dëshironi ta

1 diskutoni me Trupin Gjykues?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, faleminderit shumë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
4 mirë.

5 Atëherë, meqenëse palët dhe Mbrojtësja e Viktimave nuk
6 kanë asgjë për të ngritur, do të takohemi nesër më 29 mars, në
7 orën 9.30, me dëshmitarin 400.

8 Falënderoj palët dhe Mbrojtësen e Viktimave për
9 pjesëmarrjen. Falënderoj përkthyesit, teknikët audio vizivë,
10 stenografin dhe personelin e sigurisë për asistencën.

11 Këtu ndërpritet seanca.

12 --- Seanca mbyllet në orën 15.52

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25